



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.09.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.
3. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”.
4. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar”.
5. Projektligji “Për falimentimin”.
6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, të ndryshuar”.

#### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Edmond Leka, Eduard Halimi, Tahir Muhedini, Adelina Rista, Piro Lutaj, Xhemal Qefalia.

#### **Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Nard Ndoka, Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Arben Isaraj – zëvendësministër i Drejtësisë

Bledar Dervishaj – këshilltar i ministrit të Drejtësisë

Katrin Treska – drejtoreshë e Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Albert Pilo – drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit në Ministrinë e Drejtësisë

Tedi Malaveci – kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë

Enrieta Zisi – përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë

Alban Ruli – përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë

Saimir Hoxha – përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë

Spiro Brumbulli – sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Veronika Prifti – përfaqësuese e Shoqatës Shqiptare të Bankave

Albina Hasanaj – përfaqësuese e Shoqatës Shqiptare të Bankave

Brunilda Kostare – përfaqësuese e Shoqatës Shqiptare të Bankave

Elona Sherri – specialiste në Drejtorinë e Rregullimit dhe Standardeve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita të gjithëve!

Mund ta fillojmë mbledhjen e komisionit. Kemi çmuar që në këtë mbledhje të komisionit të organizojmë një seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”; për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”; për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar”; për projektligjin “Për falimentimin” dhe për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, të ndryshuar”.

Qëllim i kësaj seance dëgjimore është të dëgjojmë grupet e interesit lidhur me çfarë ato çmojnë të nevojshme se duhet të sjellin në vëmendje të këtij komisioni për t’i marrë në konsideratë dhe për t’i trajtuar gjatë debatit nen për nen të këtyre projektligjeve. Natyrisht që secili prej grupeve të interesit ka këndvështrimin e tij për përmbajtjen e projektligjeve dhe është i lirë ta shprehë atë, qoftë në aspektin mbështetës për çështje të caktuara, ashtu edhe në aspektin kritik për çështje të tjera që ata gjykojnë se kanë nevojë të përmirësohen. Natyrisht, ne do t’i dëgjojmë grupet e interesit. Ju lutem të gjitha grupeve të ftuara të interesit, të cilat kanë shfaqur gatishmërinë për të qenë prezente, që pas kësaj seance dëgjimore, brenda ditës së premtë, të na përcjellin një material me shkrim, në mënyrë që të jetë më praktike për t’u pasur në vëmendje nga të gjithë deputetët, në mënyrë të veçantë nga ata që do të jenë më të angazhuar në këtë çështje. Seanca dëgjimore do të organizohet në këtë mënyrë: do të bëhet një parashtesë nga grupet e interesit, secili për fushën dhe për çështjet që gjykon të arsyeshme, deputetët do të bëjnë pyetje dhe më pas do të vazhdojmë me çështjet e tjera. Do t’i lutesha një përfaqësuesi të Ministrisë së Drejtësisë të zërë vend në tavolinë, meqenëse ministria është iniciuese e projektit.

Ndërkohë, do t’iu lutesha dy përfaqësuesve të Shoqatës Shqiptare të Bankave të zënë vend për të bërë prezantimin, zotit Brumbulli, që është sekretari i përgjithshëm bashke me një person tjetër, ose mund të ulen edhe më shumë.

Fillimisht, do të dëgjojmë përfaqësuesit e Shoqatës së Bankave, pastaj ata të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë.

Zoti Brumbulli, ju do të bëni një paraqitje të gjykimit ose të vlerësimeve që keni për paketën ligjore.

**Spiro Brumbulli** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja dhe zotërinj deputetë, që na dhatë mundësinë të shprehim në këtë seancë dëgjimore mendimet tona lidhur me paketën ligjore, tashmë të kaluar nga qeveria, dhe i prezantuar te ju për miratimin përfundimtar.

Më lejoni t'ju kujtoj se arsyeja pse u iniciua kjo paketë me ndryshime është për shkak të uljes së huave me probleme, të kredive të këqija në sistem dhe të lehtësimit të sektorit bankar nga pikëpamja e shtimit të kredisë për ekonominë. Meqenëse treguesi i NPL-ve ishte i lartë, rreth 24%, dhe në masat që duheshin identifikuar nga aktorët, pra nga Banka Qendrore, nga industria bankare bënë pjesë edhe ndryshmet ligjore, në bashkëpunim me Bankën Botërore Kryeministri nxori një urdhër për ngritjen e një grupi ndërinstitucional me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë e Financave, me Ministrinë e Ekonomisë dhe me Drejtorinë e Tatimeve, si dhe me institucione të tjera, ku bënë pjesë edhe Shoqata e Bankave. Grupi ka punuar për përgatitjen e varianteve, të cilat ne i gjejmë të plota në versionin e paraqitur këtu, me përjashtim të dy gjërave në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Civil, të cilat për ne janë thelbësore Në nenin 3 të projektligjit “Për Kodin e Procedurës Civile” bëhet fjalë për një ndryshim në nenin 511. Varianti që është paraqitur te ju dhe që ka kaluar në qeveri nuk është varianti që është rënë dakord në grupin e punës për të cilin shoqata ka punuar dhe ka rënë dakord edhe me palët e tjera. Është një variant që nuk e dimë ku është formuluar dhe si ka ardhur deri këtu, pra ne e kundërshtojmë për disa arsye: është një variant për të cilin nuk është rënë dakord në grupin e punës. Në fakt, në qoftë se ndryshimi i nenit 511 kalon kështu, ne nuk kemi asnjë përfitim, përkundrazi situata bëhet më keq se është sot. Po të jetë kështu, nuk ia vlen fare ndryshimi.

E treta, nuk është në përputhje edhe me akte të tjera të rëndësishme ligjore, siç është vendimi nr. 39 i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2007, që bënë interpretimin e titullit ekzekutiv për huan bankare. Në fakt, është joreal edhe nga mënyra sesi është paraqitur dhe formuluar, sidomos paragrafi i fundit për caktimin e shumës së dëmit që mund të jetë në këtë fazë. Ne këtë e kemi parësore dhe e kemi kundërshtuar edhe në letrën që ju kemi dërguar juve zyrtarisht si Shoqatë e Bankave, ku shprehim argumentet tona përkatëse për rrëzimin e këtij formulimi dhe shtimin sipas variantit që është rënë dakord në grupin e punës dhe që është rënë dakord vetëm nga Shoqata, duhet të mirëkuptohemi. Pra, shoqata në grupin e punës ka punuar dhe ka rënë dakord me

propozimin për një shtesë në nenin 511, sipas variantit që kemi paraqitur. Në qoftë se duhet, unë mund ta lexoj. Besoj se ju e keni.

**Fatmir Xhafaj** – Mund ta lexoni. Nuk ka problem.

**Spiro Brumbulli** – Në fund të nenit 511 shtohen dy paragrafë me përmbajtjen si më poshtë vijon (ky është propozimi ynë): “Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit bazuar mbi dokumentet e depozituara në seancën këshillimore pa praninë e kërkuesit. Kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënien e kredive bankare. Gjykata në vendim duhet të parashikojë se nga data e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit deri në përmbushjen e plotë të detyrimit përfshihen kamatat ligjore në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, si edhe kushtet penale të rëna dakord mes palëve në momentin e nënshkrimit të titullit ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit”. Për këtë është rënë dakord. Kjo kërkohet të shtohet në nenin 511. Varianti që keni këtu është i papranueshëm për shoqatën. Kjo ishte shtesa për Kodin e Procedurës Civile.

Ndërkohë ne si shoqatë kemi edhe dy propozime të tjera, të cilat, në fakt, nuk janë marrë parasysh në variantin që ka ardhur në komision. Bëhet fjalë për Kodin Civil. Një ndryshim është për nenin 450. Meqenëse kemi probleme në llogaritjen e detyrimit ndaj kreditorit, sepse Kodi kërkon referencë në një ligj, kemi propozuar, në qoftë se ju do ta gjykoni të arsyeshme, të futni në Kod, jo në favorin tonë, por në mënyrë transparente edhe për debitorin, edhe për kreditorin, edhe për gjykatësit do të jetë më e lehtë, kjo përmbajtje: “Kur detyrimi i kreditorit buron nga një kredi bankare, kamata ligjore, pas datës së lëshimit të urdhrin të ekzekutimit nga gjykata dhe deri në datën e shlyerjes totale të detyrimit ndaj kreditorit, llogaritet sipas interesit të bonove njëvjeçare të thesarit plus kushtin penal, i rënë dakord mes palëve në aktin për dhënien e kredisë bankare, titull ekzekutiv”.

Së dyti, kërkojmë shfuqizimin e nenit 600, sepse është një nen i cili na ka hapur shumë probleme në praktikë. Gjyqtarët nuk mbajnë qëndrime të unifikuara dhe na ka vënë shpeshherë përballë vendimeve krejt të kundërta. Mendimi dhe propozimi ynë është që ky nen të shfuqizohet dhe nuk krijohet hapësirë boshe, sepse qëllimin e këtij neni realisht e rregullojnë dispozitat e tjera të Kodit Civil, nga neni 587 deri te neni 599.

Për projektligjet për përmbartesit dhe për falimentin nuk kemi propozime, por jemi dakord me variantet e paraqitura. Ato janë në përputhje me ato që ne kemi paraqitur në grupin

ndërinstitucional të punës. Është me rëndësi të themi që për to kemi gjetur mbështetje dhe mendim të unifikuar për të rënë dakord.

Dua t'ju bëjmë me dije edhe ju të nderuar deputetë faktin që vonesa në miratimin e këtyre ligjeve na krijon vështirësi praktike. Ditën e hënë dolën të dhënat për muajin korrik dhe huat me probleme janë rritur me 21,1%. Pra, pas uljes në muajin janar në 18%, ka filluar sërish përkeqësimi. Ne nuk e bëjmë këtë kërkesë në kuadrin e grupit të interesit, pra për të parë interesat e ngushta të bankës. Duhet të kuptojmë që kreditë, që jepen, janë me burime nga fondet e depozituesit. Pra, duke mbrojtur procedurat e kthimit të kredive të këqija, e marrjes mbrapsht të kolateralit dhe likuidimit të tyre, të konvertimit në kesh, në këtë mënyrë mbrojmë depozitat, paratë e qytetarëve, të cilat i janë lënë në besim bankës për t'u menaxhuar dhe për të siguruar kushte më të mira në financimin e ekonomisë.

Të dhënat tregojnë se financimi i ekonomisë përsëri ka qenë i ulët, biznesi është përkeqësuar në kuptimin e treguesve ekonomikë financiarë, që bankat studiojnë për dhënien e kredive. Në kushtet kur kredia nuk është në rritje dhe kur disa biznese hasin vështirësi në realizmin e atyre parametrave të paraqitura në planbiznese për shlyerjen e kredisë, treguesi i kredive të këqija është rritur dhe lehtësimi për bankat, për ekonominë, duke marrë kolaterale, pra, ne japim kredi dhe qytetari e ka të lehtë të marrë kredi, kurse ne si bankë e kemi aq të vështirë për të marrë kolateralin, nuk shkon në praktikë. Kjo nuk është një praktikë shqiptare, por është një standard ndërkombëtar, me të cilin punohet kudo. Nuk i mohojmë debitorit asnjë të drejtë. Ai mund të shkojë dhe t'i ankimojë vendimet e ndryshme, por vënia në diskutim e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit është patjetër një fazë shumë e rëndësishme dhe një pikë kritike e nisjes të gjithë procesit të likuidimit. Shqetësimet që kishim në parim ne si shoqatë kanë të bëjnë vetëm me nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile dhe me nenet 450 dhe 600 të Kodit Civil, kurse me të tjerat jemi dakord.

Faleminderit për vëmendjen!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit.

Përfaqësuesit e tjerë a kanë ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Urdhëroni, zonja Prifti!

**Veronika Prifti** – Faleminderit!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Duke pasur një eksperiencë shumëvjeçare në fushën e së drejtës bankare dhe në ekzekutimin e urdhrave të kredive me probleme, dua të ndaj me Komisionin e Ligjeve shqetësimin e grupit të bankierëve dhe të juristëve të bankave, që ndeshet përditë me ekzekutimin e parashikimeve që ka ligji.

Në qoftë se do të ndodhemi në situatën e aprovimit të propozimit të nenit 511, siç ka ardhur te ju për diskutim, do të jetë e pamundur që pa kaluar një vit apo më shumë se sa një vit nga momenti që banka paraqet kërkesën për lëshimin e urdhrin, të mund ta marrë këtë urdhër. Të mos harrojmë se neni 511, kur flet për urdhrin e ekzekutimit, nuk prek vetëm kreditë bankare, sepse urdhra ekzekutimi janë edhe vendimet gjyqësore. Çfarë do të ndodhë me ato palë, të cilat janë rraskapitur për vite të tëra në procesin e themelit, në momentin e vendimit e formës së prerë duhet të lëshojnë urdhrin e ekzekutimit, për ta vënë në ekzekutim pala në favor të së cilës është dhënë vendimi, do të ndeshet përsëri me detyrimin për të bërë një proces tjetër gjyqësor për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit?

Në radhë të parë, vetë nocioni i urdhrin të ekzekutimit nënkupton një veprim të shpejtë, imediat dhe efikas kundrejt një akti juridik, i cili ka një formë që ligji e përcakton qoftë ky vendim gjyqësor, qoftë një kredi bankare apo të tjera që neni 510 i përcakton si tituj ekzekutivë për të cilët lëshohet urdhri i ekzekutimit. Pra, duke pasur parasysh eksperiencën gjykoj se ky formulim i nenit do të vërë në vështirësi jo vetëm sistemin bankar, por të gjithë ata që duhet të ndeshen me një proces gjyqësor dhe me ekzekutimin e një procesi gjyqësor.

Nëse do të zbatonim parashikim e pjesës së dakordësisë së palëve dhe mundësinë që të projektligji i paraqitur për thirrjen e një eksperti në gjykatë, kjo nuk e lehtëson palën. Në qoftë se ideja e institucionit që e ka propozuar këtë ndryshim ka qenë që të lehtësojë qytetarët, përkundrazi ajo i rëndon. Marrim një shembull të thjeshtë: në qoftë se një qytetarë është debitor për një kartë krediti 100 mijë lekë, dhe banka do të shkojë në gjykatë dhe do të kërkojë lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për këtë kartë të papaguar, që është gjithashtu kredi bankare, minimalisht do të paguajë 32 mijë lekë për ekspertin, sepse këto janë tarifata e miratuara për ekspertin me vendimet e qeverisë. Pra, automatikisht, në mënyrë fiktive, ligjvënësi i shton shpenzimet debitorit, sepse neni 525 i Kodit të Procedurës thotë: “Çdo shpenzim që kreditori do të bëjë për efekt të nxjerrjes dhe të vjeljes së detyrimit, do t’i ngarkohet palës debitore”. Për të mos shkuar më tej, ne ndodhemi në kushtet kur legjislacioni ynë e ka të kopsitur mbrojtjen të së drejtës së debitorit nga veprime presupozuara të cenueshme të një pale kreditore.

Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile ka përcaktuar mundësinë e çdo subjekti, i cili është njoftuar nëpërmjet një akti përmbartimor për ekzistencën e një detyrimi të kërkueshëm ndaj tij, ky është momenti i parë i njoftimit për ekzekutimin vullnetar, hapi i parë që bën përmbartuesi, në këtë moment ai ka të drejtën ta kundërshtojë në gjykatë dhe në ligj thuhet shprehimisht. Përveç kësaj, gjatë vazhdimësisë së procedurave përmbartimore ndodhemi në kushtet kur përsëri debitori, hipotekuesi apo edhe dorëzanësi kanë të drejtë të përdorin mundësinë që njihet në neni 610 i Kodit të Procedurës, i cili tashmë rregullon të drejtën e palës së cenuar apo që nuk është dakord me procedurën ta kontestojë. Pra, legjislacioni ynë e ka këtë mundësi, që t'ju japë mbështetje në rastet e prekjes nga të dyja drejtimet, qoftë nga një detyrim i pretenduar si i përllogaritur josaktë, qoftë edhe nga një procedurë e cenueshme ligjore sipas Kodit të Procedurës. Për këtë arsye ne mendojmë se do të ishte më mirë, nëse nuk shihet e arsyeshme të përfshihen në propozim ato çfarë kemi parashikuar ne, për sistemin bankar, për këdo që merret me këtë gjë dhe për çdo qytetarë, i cili do të ketë nevojë ta përdorë të drejtën që njihet në neni 511, që dispozita të rrijë siç është, sesa të kthehemi 18 apo 19 vjet më pas në legjislacionin përpara vitit 1999, kur ishte ende e diskutueshme çështja e urdhrave të ekzekutimit. Fakti që është shtuar në propozimin tonë paragrafi i fundit, për t'i dhënë një mundësi reference mënyrës së përllogaritjes së detyrimit nëpërmjet bonove të thesari, që është shumë transparente dhe nuk varet nga asnjëri prej kreditorëve, është një element objektiv ka të bëjë me faktin që ne kemi dashur të jemi transparentë dhe t'i japim fund kalvarit të konflikteve në gjykatë në kushtet e mungesës së një rregullimi ligjor për çështjen e kamatës. Pikërisht, duke dashur të bëjmë këtë rregullim, duke propozuar këtë shtesë të neni 511, kemi propozuar edhe ndryshimin të neni 450 i Kodit Civil. Po t'i shikojmë të dy dispozitat e propozuara, ato shkojnë në korelacion me njëra-tjetrën, duke dashur që t'i lënë kreditorit mundësinë të ushtrojnë të drejtën ligjore dhe kontraktore, por njëkohësisht t'i thotë ndal çdo tentative abuzive dhe t'i lërë debitorit të drejtën që të mbrojë pretendimin e tij dhe të kontestojë qëndrimin e tij në çdo moment.

E fundit, për sa i përket nenit 600 të Kodit Civil, neni 600 ka një kufizim shumë strikt për sa i përket vlefshmërisë së dorëzansisë, e lidh atë me një afat 6-mujor nga mbarimi i afatit të ekzekutimit të detyrimit. Në praktikën gjyqësore nuk mund të gjejmë kurrë dy vendime gjyqësore. Ne jemi impenjuar seriozisht për ta studiuar praktikën gjyqësore në të tria shkallët e gjyqësorit dhe nuk kemi mundur të gjejmë dy vendime gjyqësore që e unifikojnë ekzekutimin e kësaj dispozite. Ndodhemi në kushtet që në qoftë se debitori është një debitor i madh dhe ka 6 muaj apo 5 muaj që është në vonesa dhe fillon procesi i ekzekutimit, në momentin që shkon njoftimi nga përmbartimi



debitori dhe dorëzanësi, që mund të jetë dhe hipotekuesi pretendon që mua më është shuar detyrimi që lind nga dorëzania për shkak se kanë kaluar 6 muaj nga momenti që debitori parësor është në vonesë.

Pra, neni 600 patjetër do një rregullim, në mënyrë që ta përfundojë mundësinë e keqpërdorimit të dispozitës ligjore nga ata që duan t'i shmangen detyrimit.

Për sa u përket ligjeve të tjera, ne nuk kemi ndonjë kontestim me grupet e punës sidomos për ligjin “Për falimentin”, kemi punuar ngushtësisht. Gjykojmë se ky ligji do të sjellë risi dhe do t'u japë fund problematikave që ka pasur përdorimi i ligjet ekzistues i falimentit i vitit 2002 dhe i amenduar, veçanërisht në vitin e fundit, kur kemi një përdorim shumë të madh dhe një fluks të kërkesave në gjykatë për çelje të procedurave të falimentit. Kështu që gjykojmë se do të ishte e pranueshme.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka pyetje për përfaqësuesit e Shoqatës së Bankave?

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Prifti dhe zoti Brumbulli!

Unë kam dëgjuar relatimin që ka bërë Ministria e Drejtësisë në paraqitjen e paketës së ligjeve, por njëkohësisht kam marrë shkresën që i keni drejtuar kryetarit të komisionit, gjithashtu kam lexuar dhe amendimet që keni bërë. Unë nuk e kam shumë të qartë problematikën lidhur me kreditë e këqija. Qeveria lehtësoi bankat para disa muajsh për të fshirë kreditë e këqija dhe ajo ulja besoj se nuk është se bankat rritën performancën e tyre, por më tepër ishte lehtësia që krijoi qeveria. Kam dëgjuar edhe dje raportin që kreditë e këqija përsëri janë rritur. Nga analiza e shkaqeve të kredive të këqija, sipas jush, cila është pesha që zënë shkaqet ligjore në rëndimin e kredive të këqija? Reduktimi i kredive të këqija lidhet vetëm me këto ndryshime ligjore apo lidhet edhe me performancën e bankave në momentin e përzgjedhjes ose të dhënies së kredive? Qofsha e gabuar, por gjatë verës kemi dëgjuar që përfitimet e bankave janë rritur shumë, ndërkohë që ekonomia, siç thatë ju, nuk ka performuar aq sa duhet? Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë lidhet edhe me atë rregullim që është parashikuar në Kodin e Procedurës Civile. Ju nuk jeni dakord që gjykata në vendimin e saj të përcaktojë kufizime të tjera që gjykata i çmon të nevojshme. Këtë pyetje ua kemi bërë edhe drejtuese të Ministrisë së Drejtësisë, por ne do

të kemi një seancë dëgjimore me ekspertë të fushës, që janë ndoshta pala kundërshtare e interesave të bankave që mbrojnë debitorët, por edhe procesin e rregullt ligjor në gjykatë. Sipas jush, cila është tërësia e problemeve që do të shkaktojë vendosja e këtyre kufizimeve? A e keni parasysh për cilat kufizime mund të vendosë gjykata që mund t'ju dëmtojnë ju si përfaqësues të bankave?

Pyetja e fundit, gjykata ngarkohet që të përcaktojë dhe të përlllogarisë detyrimet dhe kamatat, duke caktuar një ekspert. Mua më duket racional shqetësimi që ngriti zonja Prifti. Pyetja ime është: në momentin kur kërkohet të lëshohet një urdhër ekzekutimi, a i ka të përlllogaritura banka detyrimet dhe kamatat që të shmanget thirrja e një eksperti? Në relacionin që ka sjellë zoti Brumbulli theksohet se këtë gjë mund ta bëjë shumë mirë gjykata, pa pasur nevojë të ketë ekspertë. Nuk thotë se bankat janë në gjendje ta bëjnë, por thotë se mund ta bëjë gjykata.

Faleminderit!

**Veronika Prifti** - Po përgjigjem nga fundi meqenëse është më e shkurtër. Në momentin që një praktikë kredie e pashlyer paraqitet në gjykatë për të kërkuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, ajo detyrimisht shoqërohet me dokumentacionin ligjor dhe financiar provues. E para, do të shoqërohet me kontratën e kredisë, e cila është titulli për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrin, pastaj do të jetë dokumenti i bankës në të cilin detajohet detyrimi, sa ka qenë ai në mënyrë shumë të detajuar, ai që quhet vërtetimi i detyrimit në praktikën e përgjithshme, sa ka qenë kredia që ka marrë, sa ka shlyer nga kryegjësja, sa ka shlyer nga interesat, sa është përlllogaritja e interesave për periudhën e paekzekutuar, sa është kushti penal dhe sa janë shpenzimet që mund të jenë bërë deri në atë moment që mund të jenë: njësia me origjinalin, dërgime njoftimesh. Përpara se të mbërrijë në gjykatë, klientit i dërgohen dy apo tre njoftime: “Je kaq ditë me vonesë, paguaj!” Gjykata duke pasur titullin ekzekutiv në njërin krah, e ka të detajuara vlerën, afatin, kohën kur duhet të paguajë këstin, nga çfarë përbëhet ky këst nga kryegjësja dhe interesi, çfarë ndodh nëse është me vonesë, sa është penalteti? Është një shifër e përcaktuar, nuk përcaktohet më pas. Ajo nuk lëviz, është e përcaktuar në kontratë, Gjykata do të kontrollojë vërtetimin që ka nxjerrë përlllogaritjen e detyrimit që ka bërë banka dhe do të shikojë nëse banka ka përlllogaritur një detyrim 4% dhe në kontratë është 3% automatikisht gjykata e vë re papërputhshmërinë dhe veprimin jo të drejtë të bankës në përlllogaritjen e detyrimit. Nëse gjykata do të shikojë që kërkesa e bankës mbështetet në një shifër shumë më të madhe si kryegjësja, nga ajo që ka vetë titulli, natyrisht këtë mund ta verifikojë, duke krahasuar detyrimin kur llogaritet ajo dhe titullin, ndërkohë që kontratat bankare janë nga kontratat më të detajuara për shkak të problematikave. Nuk janë

kontrata që janë bërë rutinë, por janë të mirëkontrolluara, të konsultuara dhe janë marrë eksperiencia nga vendet europiane, veçanërisht nga BE-ja, në disa prej tyre në rast se shoqata e bankave kur ka pasur problematika të përfshirjes së elementeve të kontratave, ka marrë edhe konsulencë edhe nga institucionet ndërkombëtare të atashuara në Shqipëri, siç ka qenë Banka Botërore apo FMN-ja në një periudhë të caktuar. Ne gjykojmë se gjykata duke qenë profesioniste i ka mundësitë të konkludojë nëse titulli nga i cili i lind e drejta kreditorit për të kërkuar dhe përlllogaritja e detyrimit shkojnë në korrelacion me njëra-tjetrën. Ndërkohë që në rastin në të cilin ndodhemi për t'i kthyer përgjigje se çfarë do të sillte kjo vonesë, ky parashikim, minimalisht do të sillte në radhë të parë kohën. Në vjeljen e një kredie të pakthyer, koha është një element shumë i rëndësishëm, sepse tërësia e mjeteve monetare, likuiditeteve të lira të qytetarëve apo të subjekteve të depozituara në banka, të cilat banka i investon në formën e kreditimeve, ka disa rregulla që duhet të ecin dhe duhet të ketë disa likuiditete në çdo moment të caktuar. Pavarësisht se depozituesi e ka depozituar depozitën e tij dhe pas një viti do të trokasë në derë për të kërkuar depozitën plus interesin, banka nuk mund të justifikohet me faktin që x apo y kredimarrës nuk ia ka kthyer, do t'ia kthejë një për një dhe në datën që e ka kërkuar. Ligji parashikon edhe përpara datës sesa ai e kërkon, duke mbajtur pjesën e penalizimit për prishjen e parakohshme të depozitës.

Industria bankare ku do të mund t'i gjejë likuiditetet nëse vetëm për një urdhër ekzekutimi do të ndeshet në gjykatë për një vit? Për të mos thënë që futja e ekspertit do të kërkojë kohë, emërimi i tij ka në vetvete vendimin për emërimin, seancën pas një muaji, sepse nuk mund të bëhen më shpjegje, ne e njohim praktikën gjyqësore, pra pas një muaji do të vijë seanca tjetër që do të bëhet betimi dhe ai do të marrë detyrat. Pas një muaji tjetër pasi të përgatisë raportin e ekspertimit, ai do t'ia paraqesë gjykatës. Palët do të kërkojnë përsëri kohë të njihen me ekspertizën dhe të shprehin dakordësitë apo padakordësitë e tyre. Minimalisht vetëm për ekspertin ne do të kemi gjashtë seanca gjyqësore. Përlllogarisim dhe seancat e tjera që janë seanca përgatitore, vlerësimi, mosmarrja dijani e debitorit, kërkesat për shtyrje të seancave, minimalisht në rastin më të mirë është një vit për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

**Fatmir Xhafaj** – Duhet të koncentrohemi. Kam një qasje krejt tjetër nga e gjithë kjo që po flasim këtu.

Është e vërtetë që ju mbron interesat e bankës, por ne jemi këtu për të mbrojtur të gjitha interesat.

**Veronika Prifti** - Edhe interesat e qytetarëve të thjeshtë për vendimet gjyqësore.

**Fatmir Xhafaj - Dakord.**

Të mos hyjmë në detaje teknike. Ju jeni profesioniste e vjetër, unë ju mirëkuptoj që keni pasionin e profesionit tuaj.

**Spiro Brumbulli - Po jap përgjigje për pyetjen e parë.**

Faleminderit për pyetjen!

Është edhe më gjerë sesa për ju, pasi është krijuar ideja që industria bankare noton në fitime, në para. Kjo para dhe ky fitim i realizuar mund të jetë edhe për shkaqe abuzive, sepse kredimarrësit vuajnë nëpër gjykata për të kthyer kreditë, ndërkohë që bankat realizojnë fitime. Më vjen mirë që me jepet rasti që në mënyrë kategorike ta përjashtoj këtë lloj konkluzioni dhe opinionin. Bankat si të gjitha bizneset e tjera janë për fitim dhe fitimi nuk ndërtohet në një vit, bankat e ndërtojnë fitimin në vite, sepse e ndërtojnë në bazë të portofolit. Nëse sot kur interesat janë pothuajse zero, bankat për monedhën e huaj paguajnë interes, kur vendosin paratë jashtë për t'i mbajtur, ky fitim që realizohet në sistem nuk justifikon të gjitha bankat. Një-dy-tre banka mund të jenë me fitim, bankat e tjera janë me fitime shumë modeste, ka edhe nga ato që janë me humbje, pra jo gjithë sistemi shkon në të njëjtin drejtim. Aty ku punohet me standarde më të larta, me kujdes më të lartë ka edhe fitime më të mira. Pyetja ishte në kuptimin e përgjithshëm, por do të dal tek ajo se cila është cilësia e bankave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të mos kujtojmë se vetëm ky ndryshim është çelësi magjik. Në planin unik që është miratuar për uljen e NPL-ve ka detyra Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, si dhe Ministria e Drejtësisë. Në kuadrin e Ministrisë së Drejtësisë ishin ndërhyrjet në ligj që duhet të bënim. Sot ne jemi për këtë, por janë riparë rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Po shikohen procedurat tatimore. Ministria e Ekonomisë ka për klimën e biznesit, bankat kanë procedurat e tyre për rishikimin në përputhje me rregulloret e rishikuara nga Banka e Shqipërisë. Nuk është ky që do të zgjidhë të gjithë situatën, por ky është një element shumë i rëndësishëm, nëse ne do të vëmë në pikëpyetje nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit, kemi vënë në pikëpyetje të gjithë procesin. Sa e rëndon kjo? E rëndon me kohë, me vite. Një proces shkon me vite. Të marr të drejtën për kolateralin, të mbledh paratë e mia që kam dhënë, unë shkoj në një kalvar dy-tre katër vjet dhe nuk e di se kur mbaron procedura. Gjë që nuk mund të jetë në kushte normale për të bërë biznes dhe unë të mbështes financimin e ekonomisë kur duhet të vuajë kaq shumë për të marrë paratë e mia. Kjo nuk shkon.

Për sa i takon raportit debitor dhe bankës, unë nuk flas dhe mbroj interesin e bankës dhe të jem kundër debitorit. Absolutisht, jo! Debitori e ka realizuar të drejtën e tij, e ka marrë kredinë. I ka përdorur paratë dhe kredinë e ka marrë me një qëllim të caktuar dhe kundrejt disa kushteve të caktuara. Nuk është faji i bankës që kërkon kthimin e parave sipas kushteve të rëna dakord. Ky është i gjithë thelbi i kuptimit të çështjes.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit për përgjigjet!

Pasi të mbyllim pyetjet, nga Ministria e Drejtësisë do të ketë një reagim, se çfarë do të thonë grupet e interesit. Dakord.

Po, zoti Halimi.

**Eduard Halimi** - Në fakt, unë isha nga ata që kërkova të ishin prezent grupet e interesit për të na shpjeguar se ku është problemi dhe çfarë mund të zgjidhim ne me paketën. Çështja e kredive të këqija është një problem jo i ri, nuk është vetëm shqiptar. Me sa kuptuam ne nga qeveria kur e prezantoi e gjithë paketa ka ardhur e hartuar nga ekspertë apo grupi i punës së bankave. Pra, është një propozim i bankave. Deri këtu nuk ka ndonjë problem, vazhdimisht bankat e kanë shqetësimin, grupet bëjnë propozimet dhe vijjnë zgjidhjet. Meqenëse qeveria ishte jo shumë e qartë, të paktën për mua, kërkua që të ishit ju për të parë se si zgjidhet ky problem.

E para ka të bëjë me faktin dhe ju besoj e keni të qartë që e gjithë kjo paketë ligjore nuk ka fuqi prapavepruese, 21,5 % e kredive të këqija, pjesa më e madhe janë individë apo kompani. Kjo është pyetja. Pra, ku e keni hallin: e keni tek individët apo te kompanitë? Cila është pesha që keni për të zgjidhur? Gjithë kjo paketë nuk ka lidhje me ato që janë sot, por ka lidhje me të ardhmen. Këto janë ligje civile dhe nuk kanë fuqi prapavepruese.

Çështja që doja të shtroja është se problemit të kredive të këqija i është dhënë zgjidhje në disa nga vendet, të cilat e kanë pasur problem të madh, duke filluar nga SHBA-të që e kanë pasur diku nga vitet 2008, 2009 dhe më pas, në vendet e rajonit, të cilat kanë modele interesante për zgjidhjen e problemeve të kredive të këqija, po ashtu dhe Rumania ka një zgjidhje shumë interesante. Te kjo paketë që keni sjellë ju nuk shikoj asnjë nga ato modele për zgjidhjen e problemit të kredive të këqija. Pyetja që kam: për këtë zgjidhje që jepni me gjashtë ligje, që janë Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, ligji “Për falimentin”, ligji “Për përmbarimin privat dhe shtetëror”, a jeni mbështetur te ndonjë model? Apo keni bërë përsëri një model ala shqiptar, sepse mendoni se kështu mund të zgjidhet? Pse nuk i keni parë këto modele të tjera, të cilat kanë pasur

sukses? Ju besoj i dini. Unë, për shkak të njohurive dhe pasionit që kam në lidhje me fushën e çështjeve bankare, i kam shqyrtuar. Janë vërtetë interesante. Çfarë modeli keni gjetur?

Ju u morët me shpjegime gjatë gjithë kësaj kohe me 511 sepse kuptova se e gjithë paketa është hartuar nga ju, por vetëm 511 nuk është hartuar nga ju, por ka ardhur nga qeveria, dhe këtë gjë doni ta ndryshoni. Për këtë, unë nuk është se kam ndonjë shqetësim. U sqarua gjerë e gjatë. Do ta diskutojmë më pas këtë çështje.

Unë e kam problemin te kreditë e këqija. Tani, sipas jush, në gjithë këtë paketë që do të zgjidhte, ku është çelësi ku juve keni ngecur, në të gjithë procesin? Sepse mua, me thënë të vërtetën, nuk më duket recetë për ta zgjidhur problemin. Problemi është te gjykata, te procesi gjyqësor. Hiqeni atë 511 që të mos kthehemi prapë. Maksimumi i asaj që kërkoni ju, është të rrijë siç është. Por, po të rrijë siç është mbetemi përsëri në këtë çështje pra, që jemi copë. Pra, nuk ua zgjidh problemin, se që tashmë e keni problem këtë gjë. Po të rrijë ashtu, jemi në këtë gjendje. Pra e heqim këtë, që gjatë përgjigjes të mos ktheheni te kjo.

Problemi i kredive të këqija është që një debitor ka marrë një kredi 100 lekë dhe ka vënë një kolateral për 150 lekë, dhe kur vini juve tani, nuk e gjeni as 150 lekë kolateralin, nuk e gjeni as 100 lekë, por thoni që kolateralin ta vlerësojmë 50 lekë, me 30 %. Qeveria u tërhoq nga kjo. Nuk di çfarë qëndrimi do të mbani edhe juve, për uljen akoma në fund të dyshemesë, pra ta ulni akoma më shumë këtë gjë.

Ju propozoni tri zgjidhje në këtë paketë. Thoni që kolaterali të ulet në vlerën 30 % të saj. Do të më thoni edhe se ku e keni këtë, në çfarë vendi, në çfarë modeli bazoheni, që ta ulni në 30 %, kur sot është 50. Qeveria tha se do ta tërheqim. Të paktën kështu tha në seancë. E dyta thoni se kur bëhet vlerësimi, të hiqet e drejta për t'u ankuar për vlerësimin, në momentin kur vjen përmbarimi. Kjo nuk besoj se kalon dot, sepse nuk mund t'i hiqet e drejta debitorit për t'u ankuar. Pastaj e vendos gjykata.

Çështja e tretë, me të cilën mendoni se e zgjidhni problemin, është që të mos i paguani përmbaruesit në fillim, por t'i paguani me këste. Unë kështu e kam kuptuar zgjidhjen.

Por ku qëndron kleçka, ose shqetësimi juaj? 1-Te gjykata? 2-Te vlerësuesit? 3-te përmbaruesit?

Që të mos ju ndodhin më në të ardhmen, pra, që viti i ardhshëm të mos ju krijojë më këto probleme, së bashku me atë që thotë Vasilika, që është edhe fajti i drejtorëve të bankave, që japin një kredi, kolaterali i së cilës, në të vërtetë mund të bëjë 50 lekë, por vlerësuesit e bankave e bëjnë

150 lekë. Pastaj, kur vini ju për ta vjelë, sigurisht që s'e ka atë vlerë. Ndonjë tronditje e madhe, këtu te pasuritë e paluajtshme, nuk ka ndodhur, siç ndodhi në Shtetet e Bashkuara apo në vende të tjera. këtu pasuritë e paluajtshme nuk patën ndonjë inflacion. Patën ndonjë ulje të vogël.

Tani, ku e keni hallin dhe cila është receta që na propozoni ju? Gjithnjë duke e lënë 511. Që të jem i qartë për këtë ju kam thirrur. Pra, të jem i qartë s kjo paketë do ta zgjidhë në të ardhmen çështjen për kreditë e këqija që do të krijohen në 2017, 2018. Pra, që të mos iu krijohen te individët, te bankat, te kompanitë e me radhë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Po.

**Spiro Brumbull** – Tani, siç e përmendët edhe ju, NPL-ja nuk është një problem që zgjidhet me një ligj. Kreditë e këqija ekzistojnë kudo ku ka dhënie kredie. Do të ekzistojnë edhe pas kësaj, edhe sikur ne ta ulim në 10 e në 7, gjithmonë do të kemi kredi të këqija, sepse asnjëherë nuk bëhet zero dështimi në biznes. Është teorikisht e pamundur të thuash e dështimet në biznes do të jenë zero. Është utopike.

Ajo që duam të propozojmë konsiston në faktin se është e papranueshme që niveli i kredive të këqija të jetë në këtë nivel, pra në nivelin 20 %. Vetëm ne dhe Serbia i kemi sot këto raporte, këta tregues. Të gjitha vendet e tjera të rajonit janë më poshtë se ne.

Nga studimi që kemi bërë, ne shohim se kemi diferenca. Për shembull, ju thatë *success fin*, bie fjala. *Success fin* e gjejmë në Çeki. E kemi të konfirmuar në disa vende. E kemi në Serbi, e kemi në Bullgari, ku punojnë me këtë version.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po. Bie fjala....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, e përmendet edhe me këste. Thatë: pagesa me këste.

Pra, kemi marrë këto vende që e kanë. Bullgaria, për shembull, është një nga vendet që e ka të ulët NPL-në. Dy eksperiencat e mira i ka: së pari, njëherë, qartësimi i kuadrit ligjor, të gjithë procedurën e marrjes së kolateralit dhe nxjerrjes në shitje. E dyta, raportet me përmbaruesin. Por nuk mjaftojnë vetëm këto. Për shembull, ligji i falimentimit është i ri, është tërësisht i ri. Ai që ishte deri tani nuk funksiononte.

Pra, ne themi se kemi 35 kompani, të cilat janë realisht të falimentuara, nga këndvështrimi i bankave, sepse kanë marrë kredi dhe nuk i paguajnë dot më. Ato ekzistojnë, dhe me legjislacionin

ekzistues nuk i bën dot, nuk ndërmerr dot asnjë veprim. Ligji i ri që propozohet të miratohet i jep mundësi kreditorit, që të marrë iniciativën e ta çojë edhe në likuidim këtë kreditor të keq.

Ja pra, këto janë disa nga masat që ne duam të ndërmarrim. Sa do të zgjidhet? Sigurisht, nuk ka një formulë, sipas së cilës unë fus pesë dhe nxjerr tetë. Nuk është kështu. Ne duam që, kur të shkojmë në një proces me një debitor të keq, gjyqtari të jetë i qartë, dhe jo një gjyqtar ta interpretojë kështu e një tjetër ta interpretojë ashtu, por të ketë një standard. Kontrata e kredisë është titull ekzekutiv. Ne duam urdhrin e ekzekutimit dhe e gjithë procedura. Ne nuk ia heqim të drejtën debitorit të shkojë e të ankohet, por nuk mund ta vëmë në diskutim nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit...

*(Ndërhyre pa mikrofon)*

Pas kësaj do të fillojnë njëqind procedura të tjera: kundërshtime, ankimime.

*(Ndërhyre pa mikrofon)*

Jo, këtë e kundërshtojmë, sepse nuk shkon në raport me atë që kemi vënë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, nuk është se janë vetëm këto ndryshime që përmendëm, sepse të gjitha ndryshimet përmirësojnë, por me të tjerat jemi dakord. Edhe me grupin e punës është rënë dakord, pavarësisht se ne mund të kemi pasur rezervat tona.

**Eduard Halimi** – Nuk e kam të qartë. Ju mund të jeni shumë i qartë, por unë nuk e kam të qartë. Ju thoni: kemi rënë dakord, dhe ne jemi në rregull!

Unë nuk e kam të qartë, ju, si e zgjidhni problemin?

**Spiro Brumbull**– 1-E zgjidh problemin nga ana e procedurave ligjore. 2-E zgjidh problemin nga ana rregullative. 3- Që ka të bëjë me Bankën Qendrore, s'ka të bëjë me ju. 4- E zgjidh edhe me rregullore, që janë bërë më prudente në...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Që procedura të ecë e të mos bllokohet. Të mos na marrë një rast tre-katër vjet. Kredia është kredi dhe unë dua të marr kolateralin e ta nxjerr në shitje e të rikuperohet. Unë nuk i bie në qafë debitorit. Ju më thoni se i bie në qartë. Nuk e kuptoj se si i bie në qafë debitorit. Debitori ka marrë paratë e mia, paratë e bankës, paratë e depozituesve. I ka marrë kundrejt disa kushteve, që brenda tre vjetësh duhet të paguajë X para, çdo muaj, çdo tre muaj. Kur ai s'pagan, çfarë ka mbetur tjetër për të bërë? në Amerikë, brenda 24 orëve vijnë e të vënë shiritin e ta mbyllin. Ta mbyll sherifi dhe ta merr.



Ne tani themi: në gjithë këtë proces shumë normal, me të drejta transparente, me një procedurë tërësisht të përcaktuar, debitori është atje, ndërsa unë duhet të vuaj për të marrë kolateralin, për të marrë paratë e mia. Kjo nuk shkon. Kjo ma vështirëson tërë punën. Në fund të fundit, kredia është kontratë. Banka jep paratë e pastaj kontrollon nga pikëpamja e biznesit dhe nga baza ligjore. Unë do të shkoj ta kërkoj ligjërisht. Në qoftë se ligjërisht nuk funksionon, institucionet nuk funksionojnë dhe unë sorollatem, sigurisht që kjo më kthehet në humbje, më kthehet në energji të kota, nuk ka biznes.

Tani ky model është gjithandej. Nuk ka një vend që s' e ka këtë. Për shembull, në qoftë se Kosova është më mirë se ne, është pikërisht pse i ka gjërat të përcaktuara më mirë. Ne kemi parë edhe legjislativonin e Kosovës, se si i ka ligjet e se si funksionojnë.

Ne kemi edhe probleme të tjera. kemi probleme me zyrën e Hipotekës. Po, kemi probleme. Një pronë që ka qenë me certifikatë nuk figuron më me certifikatë, fjala vjen. Por këto probleme nuk i sjellim këtu. Prandaj kërkojmë që, më së pari ligjërisht të jemi të qartë dhe asnjë pjesë e procedurës të mos jetë në ekuivok, të mos jetë e diskutueshme.

Nga ana tjetër ka edhe çështje organizative, ka çështje që kanë të bëjnë edhe me institucione të tjera. Ne nuk e mohojmë këtë, por meqë po diskutojmë për këtë, këto të pesta kanë të bëjnë me kuadrin ligjor për të rregulluar e përmirësuar. Është një garanci e shtuar. Kaq.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull!

**Eduard Halimi** – Unë nuk mora përgjigje.

Ju dhatë leksion se cili është problemi i kredive të këqija. Unë e di. Ju më thatë se do t'i marrim paratë shpejt. Edhe këtë e di. Unë ju pyeta konkretisht, në lidhje me këtë paketë ligjore, që vjen këtu: çfarë ndryshimi doni të sillni? Konkretisht. Në qoftë se e keni lexuar, se mund të jetë edhe ndonjë jurist që mund ta ketë. Pra, ju propozoni tri gjëra. Unë kështu e kuptova. Në qoftë se janë pesë, m'i thoni se cilat janë këto pesë. Ju propozoni tri gjëra. Të paktën kështu e kuptova unë. Propozoni që vlera e kolateralit të ulet nga 50 % që është sot, në 30 %. Kjo është konkrete. Këtë propozim bëni. Pastaj, të bëhen shpejt, e të bëhen ashtu, këto janë pjesë leksioni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Spiro Brumbull** – Pjesë e procedurës është edhe ajo. Prandaj e them.

**Eduard Halimi** – kështu janë edhe sot. Nuk janë të përcaktuara këtu këto që po themi. Pra, ju thoni që të ulet kjo nën 30 %. Një kjo. E dyta, thoni që, kur vlerësuesi të bëjë vlerësimin,

përpara se ta nxjerrë në ankand, debitori të mos ketë të drejtë të ankimojë. E keni sjellë ju këtë propozim. Pra, është këtu.

Prandaj them unë se e drejta e debitorit nuk mund të refuzohet, dhe atij nuk mund t'i hiqet aksesimi për të shkuar në gjykatë kundër atij vlerësimi që i bëjnë. Pra, ju keni propozuar: 1- nga 50 % të ulët në 30 %. 2- keni propozuar që, kur vlerësuesi i gjykatës të përcaktojë këtë, debitori të mos ankohet, t'i hiqet e drejta për t'u ankuar. 3- keni bërë një parashikim, që në marrëdhëniet e përmbaruesit, këta përmbarues të mos i marrin paratë që në fillim, por t'i marrin me këste. Dakord! Modele për këtë ka. ne e pyetëm, do të dëgjojmë. Nuk dua tua shtroj juve këtë. Vetëm këto të dyja kam unë, të verifikuara si probleme. A ka ndonjë çështje tjetër konkrete, që ju mendoni se mund ta zgjidhë problemin në të ardhmen? vetëm me këto të dyja? Pra, nga 50 % ta ulim në 30 % dhe debitori të mos ankohet kundër masës së vlerësimit? Ka gjëra të tjera apo s'ka.

**Spiro Brumbull** – Më pas është edhe ligji i falimentit. Ju...

**Eduard Halimi** – Është edhe ligji i falimentit për kompanitë. Ai është për kompanitë dhe individët. Ju e keni problemin më shumë me kompanitë apo me individët?

**Spiro Brumbull** – Vlerën e kanë kompanitë, nuk diskutohet.

**Eduard Halimi** – Dakord! Atë e zgjidh ligji për falimentin. Për individët, keni vetëm këto të dyja, apo keni edhe të tjera?

**Veronika Prifti** – Më falni, të sqaroj: ne nuk kemi propozuar uljen e vlerës së ankandit, por ne kemi propozuar shtimin e numrit të seancave të ankandit, që është një element tjetër, një qasje tjetër. Sot kemi dy ankande. Kemi propozuar që të bëhet edhe ankandi i tretë. Natyrisht, në botë dhe në vende shumë të zhvilluara, edhe pjesë të BE-së, ka eksperiencë që në ankandet e treta zbresin në nivelin zero. Ne nuk e kemi propozuar atë.

Pak më parë ju pyetët: çfarë synoni të arrini? E thënë shumë shkurt, ne duam që, me ndërhyrjet e pjeshme në këto ligje që kanë ardhur, të heqim mundësinë e keqpërdorimit të hapësirave ligjore, pasaktësive që mund të kenë ligjet apo keqinterpretimet, qoftë nga debitorët, të cilët mund t'i përdorin se për sa janë në linjë, qoftë edhe nga pjesa e gjyqësorit, i cili ose nuk i kupton, ose nuk do t'i kuptojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo është e thjeshtë.

**Eduard Halimi** – Më ndjeni nëse unë e kam gabim!

Prandaj ju pyeta, thashë që do ta merrja përgjigjen nga ju, por nuk e mora.

Unë kam përshtypjen se problemi që ju ndodh juve në gjithë vargun për ta marrë kredinë që keni dhënë, pra te gjykata, te vlerësuesi dhe te përmbaruesi, në njohuritë dhe në dijeninë që kam unë, është te vlerësuesi, jo te vlerësuesi juaj, por te vlerësuesi që bëhet në gjykatë dhe një korporatizëm që bëhet ndërmjet vlerësuesit dhe gjyqtarit për këtë gjë.

A ekziston ky problem në vjeljen e kredive të këqija? Nëse ekziston, a keni paraqitur, a keni ndonjë amendament si mund ta zgjidhni këtë? Pra, shkon përmbaruesi dhe thotë: “Vlera nuk është 100 lekë, por 20 lekë”. Ju aty... Prandaj unë mendoj se ju e keni bërë atë që të mos ankohe vendimi, madje të hiqet edhe eksperti, siç e keni bërë propozimin.

Besoj se ju këtu e keni çelësin e problemit. Mund ta kem gabim, por a është ky problemi? Nëse është ky për bankat, keni ndër mend ta zgjidhni?

**Veronika Prifti** – Është e vërtetë që ekziston ky fenomen, por ekziston në kushtet kur, në mënyrë fiktive, pronës i rritet vlera në parametra të tillë që edhe në kushtet e shitjes normale nuk shitet. Pra, në qoftë se prona në momentin kur është marrë kredia ka bërë 80 lekë, ai e ngre në dakordësinë 200 lekë dhe banka jo vetëm që nuk merr paratë e saj, por detyrohet t’i kthejë para atij debitori, sepse në nenin 577 të Kodit të Procedurës thuhet: “Diferenca midis vlerës së çmimit të shitjes në ankand dhe vlerës së pronës i kthehet debitorit”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Pra...

Ne nuk mund të japim, por është një fenomen që është vënë.

*(Deputeti Halimi flet pa mikrofon.)*

**Eduard Halimi** – Të 35 kompanitë e çmimit këtë keni problem kryesor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Veronika Prifti** – Jo, jo, nuk është...

**Eduard Halimi** – ...problemin e vjeljes e keni, se kur vini tek iks kompani për të marrë ky pallat ose kjo vlerë, ju e keni, po themi, 100 lekë, ai e vlerës i thotë: 300 lekë dhe ia ulni sa të doni, ngel 3% dhe pastaj nuk merrni tuajat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Spiro Brumbulli** – Jo, zoti Halimi, nuk është kështu! Nuk është ky perceptimi kryesor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju mund të keni të drejtë, sepse ka raste që është edhe kështu...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo, jo...

**Spiro Brumbulli** – Por çuarja në tre ankande këtë kërkon të bëjë, që kjo vlera fiktive të ulet.

*(Deputeti Halimi vazhdon të flasë pa mikrofon.)*

Prandaj po themi me tre ankande, që të rritet deri në 30% të asaj vlere.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Spiro Brumbulli** – Po tani, nëse ju keni ndonjë model...

*(Deputeti Halimi vazhdon të flasë pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Spiro Brumbulli** – Por nuk kanë këtë kryesore.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, se nuk do të rrimë vetëm me bankat këtu!

Faleminderit, zoti Halimi!

Kishit ndonjë gjë tjetër të re që nuk u tha këtu?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk keni. Faleminderit!

Ka pyetje të tjera për bankat? Nuk ka.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Keni?

Po, zoti Muhedini.

**Tahir Muhedini** – Tani jemi mësuar gjithmonë, në fakt, si politikanë, por edhe si bankierë për popullin, për qytetarin, për gjithçka në të mirë të popullit dhe të të qytetarit.

Ore, unë dua të di këtë: kur një person merr një kredi në bankë dhe ai vendos një kolateral, merr 100 lekë kredi, ndërkohë që kolaterali është 150 lekë...Vlerësimin besoj se e keni bërë ju, që është 150 lekë, apo jo?

Ky personi nuk e lan dot kredinë dhe ju nxirrni ankand, duke e çuar ankandin deri në 30%. Ky ngelet prapë kredihënës dhe kolaterali i ikën. Ju si bankë nuk keni përgjegjësi që këtë kolateral, që e keni vlerësuar ju, që unë mora 100 lekë dhe e keni vlerësuar 150 lekë, pas dy vjetësh ti ma nxjerr mua 30 lekë?

Kjo është kryesorja, them unë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Ja, një minutë!

**Tahir Muhedini** – Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë, tani ne këtu jetojmë në Shqipëri, nuk jetojmë jashtë shtetit, jetojmë edhe me hallet e njerëzve. Ka banka, se nuk po them për cilën bankë, që një kredi të keqe ma jep mua, unë e marr badjava atë kredi dhe e shes nesër pesëfish.

Ju i keni këto raste, të mos bëjmë sikur nuk dimë gjë! Prandaj them që ju gjithçka e kërkonti që banka të jetë funksionale, banka të jetë babai i gjithçkaje dhe për këtë qytetarin, të cilit nuk i ecën biznesi apo ka arsyet e tij, ju nuk doni t’ia dini fare, vetëm, o burra, t’i marrim kolateralin këtij. Le të jetë prapë ky kredidhënës. Çfarë zgjidhjeje jepni ju si bankë? Si ka mundësi që bankat në Shqipëri dalin me fitime kolosale gjithmonë, në një kohë kur për këto fitime që bëhen në Shqipëri nuk ka asnjë bankë, po ju them juve, në Europë dhe në botë, që të ketë kaq fitime të mëdha dhe prapë ju qaheni?

Këto pyetje kisha.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Atëherë, cila është përgjigjja për pyetjet që fokusohen te përmbajtja e projektligjit?

**Spiro Brumbulli** – Lidhur me pyetjen: “A ka përgjegjësi për vlerën e kolateralit?”, banka e paguan atë përgjegjësi që ka, sepse është banka, në fund të fundit, që po e mori me 30%, pjesën tjetër e kalon në humbje. Se çfarë bën pastaj me vlerësuesit dhe me këta është pjesë e brendshme e saj. Por e paguan financiarisht. Pra, në qoftë se kishte dhënë 100 lekë për 150 lekë dhe tani nuk merr më 150, por e shet me 30%, merr 45 lekë. Domethënë, pjesa tjetër prej 55 lekësh i ka kaluar bankës në humbje. Pra, banka penalizohet në rastet kur ju mendoni që nuk shitet në atë vlerë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Tahir Muhedini** – Nuk u sqarova, më duket.

**Spiro Brumbulli** – Jo, jo!

**Tahir Muhedini** – Debitori ka një kolateral...

**Spiro Brumbulli** – Patjetër që e mbajnë, por kjo nuk është zgjidhje shqiptare, të mos flasim..! Ky është standard botëror.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, jo, nuk ka praktikë!

Jo kudo në botë, të mos...!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Shikoni, Rumania e zgjidhi problemin vetëm me frangat zvicerane, kreditë që ishin ndaj frangave. Por nuk ka të tilla.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Më falni, të mos ngatërrojmë, se këtu na dëgjojnë, kemi edhe mediet, edhe opinione dhe krijojmë përfytyrim të gabuar pastaj!

Ai mbetet debitor, patjetër që po!

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, në rregull!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Spiro Brumbulli** – Po nuk e realizoi atë që ka marrë ndaj bankës, do të mbetet debitor. Kjo është lista e zezë.

**Tahir Muhedini** – Pra, edhe kolaterali i ikën, edhe debitor mbetet.

**Spiro Brumbulli** – Kolaterali shitet për kaq sa shitet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Veronika Prifti**– A mund të shtoj diçka, të lutem?

**Spiro Brumbulli** – Kredi e keqe ngelet prapë ajo, apo jo? Këtë kisha.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Po?

**Albina Hasanaj** – Dua të garantoj...

*(Diskutime në sallë.)*

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, zoti Muhedini!

Në rregull, faleminderit!

**Albina Hasanaj** – Dua të garantoj të gjitha palët se procedura e ekzekutimit nga banka, iniciohet prej saj, por realizohet nga zyrat përmbarimore. Vlerësimet bëhen nga vlerësues, ekspertë të licencuar nga Ministria e Drejtësisë, mbi bazën e të cilëve përcaktohet vlera e çmimit të shitjes dhe mbi bazën e kësaj vlere të çmimit të shitjes përmbaruesi njofton palët: debitorin, kreditorin dhe fillon publikimin e ankandeve.

Në qoftë se flasim për një çmim shitjeje nuk mund t’ia atribuojmë bankës. Po flasim për çmimin e shitjes së asetit të pronës kolateral dhe ky çmim shitjeje bëhet mbi bazën e vlerësimit që ka bërë një ekspert i licencuar.

Në qoftë se banka del me humbje, pra kolaterali është marrë 100 lekë, kredia ka qenë 50 lekë, po them unë, dhe në momentin e shitjes shitet po 50 lekë, u shlye kredia dhe debitori këtu nuk ka më lidhje me bankën.

Në qoftë se shitet 30 lekë dhe mbetet 20 lekë debitor, prapë ky çmim shitjeje nuk u vendos nga banka, u vendos nga një ekspert i licencuar që, në bazë të asaj dispozite që ka sot Kodi i Procedurës Civile, debitori ka të drejtë të ankimojë vlerën e sendit.

Ndërkohë, arsyeja pse ne kemi kërkuar që debitorit t'i hiqet e drejta për të ankimuar vlerën e sendit është sepse edhe në momentin kur sendi vlerësohet në përmbarrim, vlerësohet nga një ekspert i licencuar i së njëjtës listë që e vlerëson edhe gjykata kur kjo e fundit cakton një ekspert për rivlerësimin e sendit.

Pra, i bie që dy profesionistë të licencuar të së njëjtës listë kontestojnë njëri-tjetrin dhe mund të japin mendime të ndryshme mbi të njëjtin send.

Kjo ka qenë arsyeja, dhe nuk është çështje përfitimi, por arsyeja është çështja e shkurtimit të kohës procedurale të ekzekutimit.

**Fatmir Xhafaj** – Që aty fillon, te vlerësimi i...

**Albina Hasanaj** – Të dy ekspertët referohen nga standarde të njëjta.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Muhedini.

**Tahir Muhedini** – Tani ne këtu...

**Fatmir Xhafaj** – Vetëm, ju lutem, nuk do të bëjmë debat!

**Tahir Muhedini** – Jo.

**Fatmir Xhafaj** – Keni pyetje?

**Tahir Muhedini** – Po, pyetje.

**Fatmir Xhafaj** – Meqenëse nuk u sqaruar, ndiheni se nuk jeni sqaruar, do të bëni pyetje prapë, por jo debat?

**Tahir Muhedini** – Më shumë teori.

**Fatmir Xhafaj** – Debat do të bëjmë në seancën tjetër.

**Tahir Muhedini** – Unë e kam këtu: huamarrësi që merr këtë kredinë ka ambientin që bën 100 lekë dhe merr kredi, por ju vlerësoni që të marrë 50 lekë, apo jo? Këtë huamarrës, pas disa kohësh që nuk e lan këtë kredi, ju e nxirrni në ankand dhe e vlerësojnë ekspertët e huaj, thoni ju, jo banka, dhe del ky nga 100 lekë, në 30 lekë. Unë ngelem prapë për t'i dhënë kredi bankës, pasi

nuk kam lekë për ta paguar, sepse unë përderisa falimentova nuk kam lekë. Kështu që banka merr atë 30-lekësh për veten e saj dhe unë ngelem prapë borxhli te banka. A ka banka përgjegjësi kur e vlerëson këtë kolateral që më jep kredinë mua? Nuk ka asnjë përgjegjësi, bëhet badjava! Prandaj kjo them unë, nuk do të zgjidhet as sot, se ne do ta kemi këtë muhabet, se kemi edhe eksperiencë dhe njerëz që na ankohen. Por këtë duhet të keni parasysh: ju vini një kolateral 200 lekë kot për të marrë kredinë ai tjetri, e fusni brenda atij tjetrit dhe ai tjetri edhe falimenton me shtëpi e me të gjitha, edhe ngelet prapë borxhli me bankën.

Nuk është një rast, për të mos thënë me mijëra, por me qindra njerëz vijnë ankohen. Pra, kjo është kryesorja me ju të bankës. Kur bëni vlerësimet, a i bëni me symbyllur, a i bëni sipas interesave tuaja, këtë e dini ju, por kjo që kam unë është thelbësore.

**Fatmir Xhafaj** – Po, faleminderit!

**Spiro Brumbulli** – Faleminderit, por kam vetëm një ndërhyrje, vetëm një fjali të fundit!

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Spiro Brumbulli** – Ne nuk e bëjmë në anën tënde, nuk e di debitori se çfarë firmos dhe se çfarë bën. Në qoftë se debitori kërkon 100 lekë dhe pasuria i vlerësohet 150 lekë për të marrë 100 mijë lekë, ai e pranon dhe nënshkruan.

**Fatmir Xhafaj** – E qartë.

**Spiro Brumbulli** – Po, nënshkruan. Pra, të mos vijë debitori dhe të ankohet: si më dhe? Le të mos i merrte kur ai e di se nuk vlerësohet 150. Kështu që mos shikoni vetëm anën e bankës...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Spiro Brumbulli** – Se nuk mund ta shikojmë dot kështu, pasi ato lekët kur i merr janë të ëmbla. Debitori i merr lekët në fillim...

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, e kuptuam!

**Tahir Muhedini** – Më duket se po e konfondoni bisedën!

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo!

**Tahir Muhedini** – Më falni, më falni!

Kur ti ia jep 150 lekë, mos e ço 30 lekë. Këtë po them unë.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem!

**Tahir Muhedini** – E lë edhe borxhli, i merr edhe shtëpinë dhe i lë borxhe bankës.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Muhedini, dakord!

**Tahir Muhedini** – Ju e çoni pra!



**Fatmir Xhafaj** – Dakord, dakord! Të lutem!

**Tahir Muhedini** – Mua më pëlqen, sepse kam shtëpinë që më vlerësohet kolaterali 150 lekë dhe marr 100 lekë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, nuk je asnjë fare ti!

**Veronika Prifti** – Ka një arsyetim ligjor për këtë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Veronika Prifti** – Lidhur me ndërhyrjen që bëri zoti deputet për rastet e marrjes së kredive dhe të ridhënies, dua të sjell në vëmendje që ka një ligj për faktoringun...

**Fatmir Xhafaj** – Po, po, po.

**Veronika Prifti** – ...dhe nuk është ajo.

Shitja...

**Fatmir Xhafaj** – Ligji “Për faktoringun” nuk është edhe aq i qartë në kuptimin që e kërkon ju, është një histori tjetër.

**Veronika Prifti** – Ai është ligj për faktoringun. Ndërkohë, në Shqipëri...

**Fatmir Xhafaj** – E keni shtrembëruar ju që... E keni devijuar atë nga thelbi, në praktikë flas.

**Veronika Prifti** – Vetëm dy banka kanë tentuar të shesin dhe nuk kanë shitur dot borxhe.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Veronika Prifti** – Ajo praktikë nuk është...

**Fatmir Xhafaj** – Por nuk kishte parasysh këtë gjë...

**Veronika Prifti** – Në qoftë se ekziston, ka dispozita që vënë para përgjegjësisë ata që e keqpërdorin.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, Veronika, por nuk kishte këtë parasysh!

**Albina Hasanaj** – A mund të shtoj vetëm diçka, nëse më lejohet, në lidhje me vlerësimet e kolateralit?

**Fatmir Xhafaj** – Po, këtu jemi të interesuar.

**Albina Hasanaj** – Bankat në procesin e kredidhënies udhëhiqen kryesisht nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Sot që flasim ekzistojnë rregullore të forta të Bankës së Shqipërisë për sa u përket ekspozimeve të mëdha të kredive, që kapin një vlerë e cila shkon te 10%-shi i kapitalit themeltar të bankave. Ndërkohë, për kredidhënien tjetër banka mund të rrisë vigjilencën në

mënyrën e analizës së riskut që i bën dosjes së kredisë, klientit, profilit të tij dhe kolateralit, por nuk ekziston asnjë detyrim ligjor, le të themi, që të ketë edhe një ekspert licencimi nga mbrapa të vlerësimit të kolateralit.

Fakti pse bankat sot, dhe jam e sigurt dhe flas me siguri për të gjitha bankat, kanë struktura të brendshme me ekspertë të brendshëm, të cilët ushtrojnë rivlerësimet e pronave, që vijnë po nga ekspertë të licencuar të jashtëm dhe bankat paguajnë tarifa të konsiderueshme për vlerësimet dhe rivlerësimet në kohë gjatë jetës së kredisë së kolateralëve.

Ky mund të ketë qenë një ndërgjegjësim, që pa frikë mund të them, se mund të ketë 5 vjet apo më shumë që bankat e kanë rritur vigjilencën e tyre jo pse kanë detyrim ligjor, por pikërisht për shkak të minimizimit të riskut që ka ardhur si rezultat i rritjes së PL-së.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Kanë gjë për të shtuar përfaqësuesit e ministrisë?

Urdhëroni!

**Spiro Brumbulli** – Kisha një koment të shkurtër vetëm për 511-ën, pa dashur të zgjatem shumë. Nga diskutimet e të nderuarve deputetë me grupet e interesit dolën pak a shumë, të gjitha problematikat. Më vjen mirë për të gjitha komentet që jep Shoqata e Bankave. Ne do të analizojmë më thellë në Ministrinë e Drejtësisë për të mbajtur edhe një qëndrim të mëvonshëm. Ministria e Drejtësisë është munduar të jetë objektive në lidhje me propozimin për 511-ën, jo vetëm nga propozimi që u dha nga grupi i punës, por duke vlerësuar edhe atë lumë ankesash që janë dhe vazhdojnë të depozitohen në Ministrinë e Drejtësisë përkundrejt ekzekutimit të detyrimeve. Aty u konstatuan disa mangësi apo vakuume ligjore në ekzekutim, ku kishte vendime gjykatash pa vlerë, ku lëshohej një urdhër ekzekutimi kundrejt një kontrate bankare dhe vijonte të llogaritej ende detyrimi deri në ekzekutim e të tjera si këto.

Është e vërtetë që parimi i kontradiktioritetit njihet në kod, siç u tha nga të gjithë, por pasi lëshohet urdhri i ekzekutimit, i bie barra debitorit të shkojë dhe të kundërshtojë në gjykatë, pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, pezullimin e veprimeve përmbarimore, për shkak se nuk bie dakord me vlerën etj. Në këtë mënyrë, ne vlerësuam që këtë parim ta s'postojmë më përpara, në atë moment kur përcaktohet detyrimi dhe u tha që urdhri i detyrimit është mirë të lëshohet përballë palëve dhe në rast alternativ, kur palët do të kenë ballafaqimin e tyre, gjykata mund të caktojë një ekspert që nxjerr detyrimet. Ne vlerësuam se ky propozim ishte midis balancës së interesit publik

për të krijuar një mekanizëm më shumë dhe për të ndikuar në uljen e kredive të këqija, por edhe për ruajtjen e sigurisë juridike për palët debitore, që janë me shumicë.

Megjithatë, më lejoni t'ju kujtoj që në prezantimin e projektit të parë të këtij projektligji, sidomos të projektligjit “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror”, ministri Manjani u shpreh në fund, se ishte i hapur për përmirësimin e produktit. Për këtë arsye ne do t'i vlerësojmë edhe një herë të gjitha propozimet dhe komentet tuaja dhe do të kemi një koment edhe për komisionin, në vijim të diskutimit.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Për ta përmbyllur, më duhet të them se kishte shumë interes për ne opinionin e Shoqatës së Bankave dhe në përgjithësi opinionin që kanë bankat. Natyrisht, bankat janë një grup interesi i rëndësishëm në të gjithë këtë proces, sepse sjellja e bankave në treg nuk është sjellja e çdo lloj biznesi. Sjellja e bankave në treg ka të bëjë drejtpërdrejt me qytetarin, me ekonominë e vendit dhe me sigurinë e vendit. Nga kjo pikëpamje, banka nuk mund të sillet si një subjekt që mund të bëjë ç'është do të bëjë në treg, sepse është e vërtetë ajo që thotë ju që banka e paguan, por nuk e paguanë aq bankat si biznes, por e paguanë edhe këto elemente dhe për këtë arsye është një interes i madh publik për këtë gjë. Prandaj ka interes të veçantë ligjvënës.

Ajo që ne nuk arrijmë të kuptojmë qartë, janë disa elemente:

I pari, është fakti që legjislacioni i kësaj fushe ka ndryshuar disa herë dhe insistues dhe iniciues të këtyre iniciativave, kanë qenë po bankat me mbështetjen e Bankës Botërore dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare. Situata nuk ka bërë përpara, por ka ardhur duke u rënduar. Kjo na çon në një konkluzion, se cilat janë hapat që janë hedhur dhe cili ka qenë efekti i tyre, si dhe kush na siguron ne që edhe ky hap i ri në ndryshimin e legjislacionit, do të ketë produkt pozitiv. Duhej ta kishim marrë këtë përgjigje, të cilën nuk e morëm qartë.

E dyta, që është shumë e rëndësishme: ju me të drejtë thotë se gjithë paketa që ka sjellë qeveria, të cilën thotë se e mbështesni, natyrisht, me objeksionet dhe me rezervat tuaja, natyrisht, sepse ka vend për ta pasur këtë rezervë, lidhet me faktin për të përmirësuar kreditë e këqija. Unë bie dakord me shqetësimin tuaj që shifra e kredive të këqija është e lartë. Ajo e cila nuk arrij dot ta ndaj, është se kreditë e këqija mbeten përsëri problem për ekonominë. Problemi i bankës mund të zgjidhet në një farë mënyre (mund të procedohet më shpejt, mund të marrë një pjesë të kolateralit), por kreditë e këqija mbeten problem. Pra, ne, si ligjvënës dhe shoqëria, jemi të

interesuar jo thjesht të zgjidhim hallin, i cili nuk është vetëm halli juaj, por është halli i të gjithë shoqërisë, e një aktori në treg, por të zgjidhim problemin që ka tregu. Ajo që nuk na bind me këto masa, është se nuk zgjidhet problemi i tregut, sepse argumentet që dhatë ju, nuk janë bindëse. Është e vërtetë që ju mund të bëni 1-2-3 ankande, mund ta ulni 30-20, por problemi i kredive të këqija me këto masa, mund të ketë përmirësime, por nuk zgjidhet plotësisht. Indikatorët që përmendët ju mund të jenë bindës në një farë mase, por ne nuk arrijmë të shkojmë në përfundimin që e gjithë kjo tërësi masash do të japë këtë produkt.

Elementi i tretë që kisha, të cilin edhe zona Hysi, edhe zoti Halimi e qartësoi, edhe kolegu Muhedini insistoi, ka të bëjë me atë se cilat janë hallkat që janë në këtë proces. Thamë që hallka janë: vlerësuesit, gjykata me procedurën që ndjek dhe përmbauesit, sepse kreditori dhe debitori janë aktorët, janë ata që kanë problemin dhe midis tyre, janë këto tri hallka.

Ndërkohë që ju pretendoni që me disa rregullime zgjidhet halli i gjykatës, sepse do të ketë procedura më të shpejta e të tjera, pretendoni që me ndryshimet që i bëni funksionit të përmbauesit, i cili është shumë i diskutueshëm nga pikëpamja e efektit që mund të ketë dhe raportit tuaj me përmbauesin, por gjithsesi, ky është një hap përpara. Dakord, mund të jetë. U ngrit problemi i vlerësuesit. Mendoj se këtu ka diçka që nuk shkon. Ky është opinioni, sepse nga vlerësimi fillestar i pronës dhe vlerësimet që pëson prona më mbrapa, sepse banka në vetvete mund t'i ketë politikat e shëndetshme, por disa nga njerëzit që janë në banka, mund të jenë bërë milionerë me këtë më shumë se vetë debitori, për shkak të këtyre proceseve. Të gjithë duhet të mbajmë përgjegjësi për ta zgjidhur këtë problem që ka tregu. Do të donim të dinim hallkën “bankë” në këtë proces, në funksion të sigurisë publike, të ekonomisë, të stabilitetit, kush do të na e zgjidhë dhe si? Ky është vetëm një këndvështrim dhe ne mendojmë se që këtu gjenerojnë problemet. Nuk i përjashtojmë edhe problemet e tjera. Jam dakord t'i shohim. Është shumë mirë që është bërë një ligj i veçantë, i përmirësuar për falimentin dhe ndoshta mund të përmirësohet më shumë në këtë proces, por këtë hallkë kush do ta zgjidhë?

Zoti Halimi tha me të drejtë më parë: “Më thoni një vlerësues që ju e keni çuar që t'i hiqet licenca, apo të ketë përgjegjësi penale, apo që nëpunësit e bankave të kenë përgjegjësi penale për këtë gjë (që kjo është një histori tjetër).”

Për gjendjen e tregut këtu, këto janë disa pyetje, të cilat ne do të donim që edhe në vijim, ju të mund t'i debatoni. Ne do t'i diskutojmë këtu dhe për aq sa kemi mundësi, do të mundohemi të reflektojmë, se për këtë i bëjmë këto konsulta, por duhet të jemi të ndërgjegjshëm që ky është

një proces me disa hallka dhe me disa aktorë, ku secili duhet të marrë në fund fare përgjegjësinë e vet. Jemi të shqetësuar, sepse për disa nga këto hallka nuk besoj se zgjidhja që keni dhënë është plotësisht zgjidhja e duhur dhe për disa të tjera, nuk ka fare zgjidhje ose ua keni lënë në dorë rregullave tuaja të brendshme apo lojës suaj të brendshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, por BSH-ja është pjesë e këtij sistemi bankar është dhe nuk është pjesë e sistemit legjislativ. Edhe te bankat është çështja e vlerësimit të riskut që e kanë çuar gjendjen në këtë nivel. Oficerët e kredive të bankave janë ata që i kanë bërë kreditë e këqija, s'i kemi bërë ne.

Është e vërtetë ajo që thatë ju, që mban përgjegjësi debitori, kur firmos. Po ky që e lëshon? Pse duhet të vazhdojmë t'i japim lehtësi të tjera këtij? Jam dakord që t'ia vëmë këmbët në një këpucë debitorit që ta shlyejë debinë, por po ky tjetri që e bën këtë gjë dhe që i krijon ekonomisë, shoqërisë, njerëzve, stabilitetit ekonomik, financiar, probleme?

Do të donim që ju t'i trajtoni këto çështje dhe kërkojmë që edhe në materialin që do të sillni me shkrim, të jeni më shterues në mënyrë që ta ndihmoni edhe komisionin në vendimmarrje. Ne jemi të hapur që edhe në vijim të ulemi dhe t'i debatojmë këto gjëra. Ndërkohë, do të dëshiroja që ju t'i dëgjoni edhe përfaqësuesit e AMF-së, që kanë diçka shkurt që lidhet me ju, edhe përfaqësuesit e përbarimit. Do të doja që nëse keni ndonjë ndërhyrje, ta bënit, sepse është më mirë ta bëni këtu, sesa të flasë secili për hesap të vet.

A mund të uleni nga ky krah?

Ju falënderoj të treve!

Fjalën e ka përfaqësuesja e AMF-së, e cila kishte një ndërhyrje të vogël për ligjin “Për falimentin”.

Mund të prezantoheni!

**Elona Jakupi** - Ju falënderoj!

Unë jam Elona Jakupi nga AMF-ja. Ne kishim vetëm një sugjerim për të ndryshuar pikën 4, të nenit 7, të projektligjit “Për falimentimin”, ku janë përjashtuar shoqëritë e sigurimeve dhe institucionet financiare nga zbatimi i këtij projektligji. Duke qenë se në ligjet e fushës, si shoqëritë e sigurimeve dhe institucionet e tjera financiare, procedurat e falimentimit kanë vetë disa dispozita të caktuara për disa çështje specifike, por pjesa tjetër e procesit të falimentit qëndron përsëri pjesë e ligjit “Për falimentimin”, sugjerojmë që ky ligj të zbatohet edhe për shoqëritë e

sigurimeve, edhe për institucionet financiare jobankare, nën mbikëqyrjen e AMF-së, për aq kohë sa ato nuk bien ndesh me dispozitat që janë në ligjet specifike të fushës.

Më konkretisht, kemi sugjeruar që pika 4 të riformulohet: “Procedurat e falimentimit të parashikuara në këtë ligj, zbatohen edhe për shoqëritë e sigurimeve për aq sa nuk bien ndesh me ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Ky ligj zbatohet edhe për institucionet e tjera financiare jobankare, nën mbikëqyrjen e AMF-së, për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjet e posaçme në fuqi”.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Dakord. Faleminderit!

Ia dolët ta prezantoni, jo që të futet në ligj, sepse ajo është një çështje shumë e diskutueshme, por nuk do ta debatojmë sot, sepse ka risk.

Ftojme përfaqësuesit e Shoqatës së Përmbauesve, për një paraqitje të shkurtër. Ju e keni sjellë materialin me shkrim, por dua që të fokusoheni te çështjet kryesore. Fillimisht bëni një prezantim të ekipit që jeni në panel, në mënyrë që të dinë edhe kolegët se kë kanë përballë.

**Tedi Malaveci** - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë quhem Tedi Malaveci dhe jam kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privat. Shoqërohem nga kolegët e mi, Genta Bungo, e cila është sekretare e përgjithshme e Dhomës si dhe anëtar i këshillit drejtues të kësaj dhome, zoti Lorval Petani.

Fillimisht dua t’ju falënderoj për këtë mundësi ligjore, e cila është jo vetëm hera jonë e parë në një komision kaq të rëndësishëm dhe të nderuar, por është edhe hera e parë që një interesim zyrtar, konkret, institucional kërkon mendimin tonë në lidhje me profesionin që ushtrojmë ne si përmbaues privatë tashmë prej gjashtë vjetësh. Si përfaqësues i shërbimit përmbauesor privat, i cili përbën edhe grupin e interesit që preket drejtpërdrejtë prej projektligjeve që po shqyrtoni, kam detyrimin ligjor, profesional, por edhe një detyrim personal moral, për të shprehur shqetësimin e madh ndaj kësaj pakete ligjore të propozuar, e cila në rast miratimi, për mendimin tonë do të sillte probleme thelbësore, substanciale, po aq sa dhe parimore, teknike, apo probleme të zbatimit.

Së pari, në vlerësimin tonë, duke filluar që prej origjinës së konceptimit të kësaj pakete, gjykojmë se edhe pse të trajtuara si projektligje me karakter thjesht teknik, ato nuk konstatohen se janë të tilla, kjo për sa kohë ndikojnë në mënyrë thelbësore dhe të drejtpërdrejtë te boshti parimor i shërbimit që ne kryejmë. Nuk besojmë se mund të pranohet brenda ndonjë konteksti logjik, se

shërbimi përbarimor si një instrument jetik i sistemit të së drejtës, mund të jetë mjete për të arritur qëllimet praktike të një grupi tjetër interesi, në dëm të ekuilibrit dhe harmonisë në marrëdhënie juridike brenda një shoqërie apo komuniteti. Por edhe nëse e marrim të mirëqenë faktin se këto ndryshime apo propozime, i shërbejnë kauzës tashmë fenomen të uljes së kredive të këqija në vendin tonë, sërish konstatojmë një qasje të dështuar pasi në analizën e të gjitha ndryshimeve, duke i vlerësuar ato një për një, konstatojmë se ato do të prodhonin vetëm një efekt, atë të kolapsit të dispozitave ligjore, të cilat me paqartësinë e tyre evidente do të krijonin një kontradiktë penalizuese për të gjitha palët e përfshira në një proces të ekzekutimit përbarimor.

Së dyti, vlerësimi i kësaj pakete projektligjesh, gjithmonë i referohem amendimeve të Kodit të Procedurës Civile apo propozim-amendimeve të ligjit të shërbimit përbarimor privat, do të duhet të bëhet edhe mbi kriterin e riskut që mbartin ato. Pra, në çfarë rreziqesh ekspozojnë vetë sistemin e së drejtës, pasi ne mendojmë se në rast se këto propozime kalohen dhe miratohen nga ana juaj, atëherë rrezikohet vetë ekzistenca e shërbimit përbarimor në tërësi, apo themeli i misionit të tij publik në veçanti. Te propozimet e kësaj pakete projektligjesh, evidentohen qartë disa nga ato që ne i quajmë probleme, rreziqe teknike apo problematika të zbatimit. Kërkesat për ndryshime, shtesa dhe amendime të neneve 511, 515, 525, 564, 577 dhe 609 të Kodit të Procedurës Civile, sikurse edhe të neneve 47 dhe 48, të ligjit organik të Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Privat, në një analizë të detajuar juridike paraqesin deformime të rënda dhe ekspozojnë një risk të pamatshëm për interpretim abuziv të dispozitave si të Kodit të Procedurës Civile, ashtu edhe të ligjit organik përbarimor privat.

Për shembull, propozimi që sjell neni 2 i projektligjit, i cili kërkon të ndryshojë nenin 48 të ligjit aktual, 131, e ka të pamundur kryerjen e një interpretimi korrekt apo të njëjtësuar të kësaj dispozite. Brenda dispozitës së propozuar, gjejmë doza të larta konfuziteti në përdorimin e shprehjeve gati sinonime me njëra-tjetrën dhe më lejoni t'ju citoj tri prej tyre.

Veprime të mëtejshme procedurale deri në ekzekutim përfundimtar.

Veprimeve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, sikurse edhe shprehja e papranueshme si nga pikëpamja formale, por edhe nga terminologjia juridike, “çdo procedurë tjetër ligjore e suksesshme”.

Pra, besojmë se e konstatojmë edhe ju paqartësinë, evazivitetin apo frazat e palejueshme të përdorura për veprime ligjore, të cilat sipas ligjeve aktuale procedurale apo organike, janë të mirëpërcaktuara. E si mund të aplikohet apo zbatohet një dispozitë ligjore, për sa kohë ajo nuk

arrihet të interpretohet apo të kuptohet qartë. Në këtë kontekst, lindin pyetjet se çfarë nënkupton një procedurë e suksesshme përmbartimore dhe a është ndjekja e hapave të mëtejshme procedurale deri në ekzekutimin përfundimtar përmbartimor, një procedurë e suksesshme? Nëse po, ku ndryshon pika “a” nga pika “b” e nenit 48 të propozuar dhe a është tarifa bazë e njëvlershme me tarifën e suksesit?

Ky problem teknik derivon në një problem tjetër juridik, atë të pasigurisë ligjore, pasi në këtë normë nuk e interpretojmë dot drejt. Atëherë është e pamundur që kjo normë të mund të zbatohet dhe mundësia e përdorimit ndryshe dhe abuziv të saj rritet. Tashmë, problemi teknik mund të shndërrohet në një problem akoma më të madh substancial dhe logjik, pasi vetvetiu lind pyetja, dhe kur brenda një norme juridike apo dispozite të tillë lexojmë fjalën sukses, cili do të ishte kriteri i suksesit dhe në rastin konkret, çfarë do të thotë përfundim me sukses i një procesi përmbartimor nga ana e një përmbartuesi, kur dihet se veprimet e tij ligjore janë veprime të përcaktuara dhe të detyra në afate dhe ligj?

Po hapat e mëtejshme procedurale që propozon dispozita cilat janë? Ndjekja e hapave të mëtejshme procedurale, sipas Kodit aktual të Procedurës Civile, është sukses apo detyrim ligjor? Si mund të jetë, apo të kërkohet të emërtohet sukses ndjekja e veprimeve ligjore strikte të përcaktuara në Kodin e Procedurës dhe në këtë sens juridik do të pyesnim hartuesit e dispozitës së propozuar, se çfarë është kjo procedura tjetër ligjore e suksesshme? A është ndonjë procedurë ekstraprocedurale? Të gjitha këto pyetje, të cilat pasojnë varg në mënyrë logjike njëra-tjetrën, janë pyetje që manifestojnë pasigurinë dhe pakuptimësinë e kësaj dispozite të propozuar.

Këtu vlen të evidentojmë edhe faktin, se teknika legjislativë e përdorur nga draftuesit konceptues të këtij projektligji, tregon një mungesë të theksuar respekti jo vetëm për drejtësinë civile, por edhe për vetë ju anëtarë të këtij komisioni të nderuar që do ju duhet të shqyrtoni këtë projektligj.

Duke iu rikthyer sërish qëllimit të synuar me mjetin e përdorur, ku në relacion thuhet se ky ndryshim do t'i shërbejë reduktimit të kredive me probleme në Shqipëri, pyesim përsëri se në çfarë mënyre dispozita e sipërpërmendur, të cilës nuk arrihet që t'i bëhet dot një interpretim uniform, do t'i shërbejë këtij qëllimi, pra, uljes së nivelit të kredive të këqija në Shqipëri? Pra, si do mund të ndikojë te parametri i efijçençës në përmbartim, kur koha e ekzekutimit apo shpejtësia e procesit që përcakton ritmin kohor të një procedure përmbartimore, është e fiksuar më se qartë dhe madje e mirëpërcaktuar nga kodi ynë aktual, si në afate ashtu edhe në hapa të detyrueshëm



procedural. Pra, jemi përballë propozimit të një norme, e cila nuk ka asnjë mundësi që t'i bëhet interpretimi drejt apo një zbatim i tillë, dhe për rrjedhojë, kjo do të sillte mundësinë e cenimit apo shkeljes së të drejtave.

Duke lexuar më tej ndryshimin e propozuar të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile, ku konfigurimi kërkohet të jetë i tillë; “tarifat e përcaktuara për ekzekutim, mund të paguhen fillimisht nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës i ngarkohen debitorit”. Pra mund. Menjëherë lindin pyetje të tjera si për shembull, se kush do ta ketë diskrecionin apo vlerësimin e mundësisë të parapagimit të tarifave? Mbi bazën e kujt vullneti do të përcaktohet kjo mundësi dhe a do të kemi tashmë një proces negociues për këto mundësi? Fjala evazive “mund” brenda konceptit të Kodit të Procedurës Civile është e papranueshme. Futja e kësaj fjale si nocion brenda Kodit të Procedurës, i cili duhet të ofrojë thjesht dhe vetëm qartësi maksimale, duket se kërkon t’i japë fund apo të radikalizojë edhe vetë statusin e përmbaruesit gjyqësor, si një funksionar publik i pavarur.

Po kështu, konstatojmë se propozimi për riformulimin e nenit 511-të të Kodit të Procedurës Civile, dukshëm është një propozim konfuz dhe kundërthënës. Madje, propozimi i nenit 51-të, duket se ngatërron në formën e paraqitur edhe vetë operatorin kryesor, kreditorin. Propozimi konfondon kërkesën e thjeshtë të kreditorit me kërkesëpadinë që ai mundet ta bëjë në gjykatë për rastin e lëshimit të një urdhri ekzekutimi. Pra, evidentohet një nonsens juridik, pasi sipas formulimit të propozuar, pretendohet të kalohet në një proces të shqyrtimit gjyqësor duke anashkaluar tërësisht parimin e kontradiktoritetit.

Duket se projektligji kërkon të radikalizojë konceptin e lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit, duke e kthyer procesin gjyqësor në gjykim themeli, por as këtë nuk ka arritur ta realizojë, pasi dispozita e propozuar brenda saj përmban një frazë kontradiktore, të cilën po e citoj; “Mos prania e palëve nuk përbën shkak për shtyrje”. Lëshimi i urdhrimit të ekzekutimit sipas këtij propozimi, do të kërkonte kryerjen e dhjetëra seancave të shtuara gjyqësore bashkë me njoftimin e debitorëve, çka nënkupton që nuk do të kishim më një proces të shkurtër dhe efikas siç është sot për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, por një proces që do futet në një kalvar pa mbarim.

Më tej kemi konstatuar edhe një problem kushtetues, që lidhet me propozimin për ndryshimin e nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile. Te ky propozim evidentohet heqja e së drejtës së ankimit pa një motivim të arsyeshëm, të nevojshëm dhe objektiv tej kufijve të proporcionalitetit të masës së marrë. Ky propozim do u hiqte debitorëve çdo mundësi për t’u mbrojtur nga papërgjegjshmëria e kreditorëve në lëshimin e vërtetimeve të detyrimit, të cilat

rrjedhin nga kontratat e kredive bankare. Po kështu, arbitraritet konstatohet edhe në propozimet për ndryshim të neneve 564 “Për vlerën e sendit të sekuestruar” dhe 577 “Për përsëritjen e ankandit”. Me ndryshimin e nenit 564, po kërkohet që të përcaktohet vlera e pasurive të paluajtshme nëpërmjet një metodologjie unike dhe procedure të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave dhe jo nga diskrecioni i pavarur i një eksperti të fushës apo nga vlera e tregut të vlerësimit të pasurive kolaterale në kohën e sekuestrimit apo të vlerësimit të tyre.

Gjithashtu, është rast i rrallë të konstatohet kur një kod procedure të referojë dhe të autorizojë direkt te një akt normativ, siç është Vendimi i Këshillit të Ministrave, duke kapërcyer në këtë mënyrë autorizimin që do të duhet t’i bënte ligjit. Propozimet, sidomos ai i nenit 577, ku kërkohet të zhvillohet një ankand i tretë, në të cilin vlera e pasurive të paluajtshme do të ulet deri në 30% të çmimit të vlerësimit të tyre, dukshëm kërkojnë të zhvlerësojnë në mënyrë drastike kolateralin e lënë nga debitorët, i cili përveç rëndimit të pozitës së tyre nuk do i shërbente as palëve kreditore dhe për më keq do të godisnin çështjen e kredive të këqija, të cilën do ta fusnin përfundimisht në një rreth vicioz.

Konstatojmë se relacioni që shoqëron propozimet për ndryshimet e dispozitave të Kodit të Procedurës nuk përmban asnjë fjalë të vetme tek e cila do të mbështetej qoftë edhe një arsyetim, shpjegim apo element bindës se përse neni 577 do të duhet të ndryshojë, apo pse kjo iniciativë do të duhet të ndërmerret. Përsëri lindin pyetje të tilla, si për shembull, kujt i shërben ky ndryshim në këtë projektligj, cilit target grupi, kreditorëve, debitorëve, përmbauesve apo sistemit të drejtësisë? Kjo është harresë e hartuesve të relacionit shoqërues?

Atëherë, po kërkoj ta përmbledh qëndrimin tonë si grup interesi, duke prezantuar edhe disa fakte të shkurtra përpara jush, shumë shkurt.

Prej disa vitesh kauzusi i kredive të këqija në vendin tonë është bërë evident dhe publik, dhe realiteti i përshkrimit tij është reduktuar vetëm duke fajësuar vetëm kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë me të gjithë operatorët e tij brenda, sidomos operatorët përmbauesve. Ne si përmbaues privatë kemi qenë më të anatemuarit në këtë drejtim, duke fajësuar shpesh për moseficientë në ekzekutimin e kolateralit, ku brenda disa viteve është kërkuar të ndryshohet pikërisht legjislacioni që ka të bëjë me ekzekutimin përmbauesve. Kujtojmë këtu për më shumë se dy herë ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile, apo tre herë në 5 vjet ndryshimet që ka pësuar ligji organik i përmbaimit privat, për të mos harruar udhëzimet në zbatim të tij apo edhe faktin e fundit, ku plani i masave që solli këto propozime që ju po shqyrtoni sot, është një plan i cili nuk

përfshiu në hartimin e tij pikërisht grupin tonë të interesit, atë që supozohet se do të duhet ta jetësojë atë, pra ne përmbartesit gjyqësorë. Megjithatë, Dhoma Kombëtare ka vazhduar përpjekjet e saj për të kontribuar në zgjidhjen e problemit të kredive të këqija në vendin tonë. Ajo prej më shumë se një viti ka qenë dhe mbetet pjesë aktive e procesit të reformës në sistemin e drejtësisë. Në Komisionin e Posaçëm të Reformës në Sistemin e Drejtësisë ne kemi paraqitur draftin tonë të ligjit përmbartimor dhe të ndryshim amendimeve apo shtesave të nevojshme në Kodin e Procedurës Civile, i cili ka propozime konkrete shumë të rëndësishme, të kryera nga bashkëpunimi me ekspertët më të mirë të fushës, ndërkombëtarë dhe vendas. Pra, gjendemi përpara propozimeve legjislativë të miratuara që ndodhen jashtë procesit të reformës në drejtësi dhe propozimeve të kryera nga Dhoma e Profesionistëve të Përmbartimit brenda paketës së kësaj reforme, të cilat paraqesin kryekëput angazhim tjetër, po aq sa edhe të kundërt me profesionin tonë. Në këto kushte, a do të duhen të imponohen dhe të miratohen këto ndryshime themelore mbi profesionin tonë, që janë krejtësisht jashtë vullnetit dhe bindjes profesionale të Dhomës Kombëtare të Përmbartesve Shqiptarë? Ne si grup interesi kërkojmë që ju të mos i merrni në konsideratë ligjore ndryshimet e propozuara për dy projektligjet e përmendura më sipër, pasi mendojmë se mbrojtja e interesit publik, më tepër se interesave të një grupi të caktuar interesi, do të duhet të jetë e vetmja filozofi mbështetëse e miratimit të këtij ligji.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, faleminderit!

Kush ka pyetje? Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Malaveci dhe zonja Bungo, ju keni depozituar në muajin korrik të vitit 2016 qëndrimin e Dhomës Kombëtare të Përmbartesve Gjyqësorë Privatë dhe unë jam relatorja e të dy projektligjeve që ju po kundërshtoni sot së bashku edhe me ligjin e falimentit. Një sërë shqetësimesh që ju i keni ngritur, unë ua kam bërë si pyetje përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë në prezantimin e nismës dhe pres reagimin e tyre. Ju ndoqa me vëmendje dhe ju thatë që nuk jeni përfshirë në draftimin e këtyre ndryshimeve, por ndërkohë keni depozituar pranë komision

*ad-hoc* të reformës në drejtësi disa përmirësime, ose nismën për një ligj të Shërbimit Përmbartimor Privat.

E para, në nismën që ju keni depozituar në Komisionin e Reformës në Drejtësi, a përfshihet edhe rregullimi i këtyre neneve që janë objekt i ndryshimeve në dy nismat ligjore që ne po diskutojmë?

E dyta, ju bëtë shumë vërejtje, kritika, pyetje, të cilat i kemi parashtruar edhe ne, por unë bashkë me kolegët e komisionit do të donim që të kishim riformulime, sugjerime konkrete. Shoqata e Bankave erdhi me sugjerime konkrete, që nenin 511 nuk e duam në këtë formë, ose nenit 511 do t'i shtohet edhe ky paragraf. A është e mundur që edhe ju në ditët në vazhdim, përpara se ne të fillojmë diskutimin nen për nen të projektligjit të kemi riformulimet që ju mendoni, por gjithmonë duke mbajtur në balancë reduktimin e kredive të këqija, Shërbimin Përmbartimor Privat, jo thjesht në interes të zyrave dhe të përfitimeve tuaja, por në zgjidhjen e një problemi, ku interesat e kreditorëve dhe të debitorëve të jenë të mirëbalancuara. Ju keni kundërshtuar fort tarifën e suksesit dhe përsëri po e kundërshtoni, nëse ju thoni që kjo tarifë nuk ekziston në vende si Gjermania dhe Anglia, por unë e di që ka vende të tjera që e kanë tarifën e interesit, ose të paktën në nismën e sjellë nga qeveria është përmendur në relacion që tarifa e suksesit është një tarifë që ekziston. A mundet të kemi disa elemente se ku parashikohet tarifa e suksesit dhe sa përfshihet ajo? Gjithashtu, zoti Malaveci, do të doja që në dokumentin me shkrim të sillni se cila është arsyeja që ju thoni se tarifa bazë, tarifa e veprimeve të mëtejshme procedurale dhe tarifa e suksesit është e vështirë për t'u dalluar, domethënë, për të bërë dallimin midis paragrafit “a” dhe “b” të nenit 48. Cila do të ishte formula që do të donit?

Në mendimin tim personal, të më falin pjesa tjetër e kolegëve, sikurse bankat shohin portofolin e tyre për të përfutur sa më shumë nëpërmjet atyre kontratave shpeshherë të padëshifruara dhe të vështira për t'u kuptuar, por nuk qëndron më pak edhe përmbartuesi privat, që në një kohë shumë të shkurtër nxjerr përfitime shumë të mëdha, si mundet të vëmë një balancë shumë të mirë që ju të funksiononi, por që debitori, qytetari, personi fizik apo juridik të mos rëndohet?

Ne kemi një shqetësim lidhur me ankandin e tretë, që e kemi ngritur edhe në diskutimin e projektligjit. Ju e dini që në vitin 2013 kemi pasur debat shumë të madh...

**Fatmir Xhafaj** – Të mos përfshihemi aty, lëre punën e vlerës, sepse e gjykojmë ne, çfarë pune kanë ata?

**Vasilika Hysi** – Ju thatë që ankandi i tretë me këtë vlerë nuk e zgjidh problemin e kredive të këqija. A mund të na sillni disa alternativa se si mundet Shërbimi Përmbartimor Privat të

kontribuojë në zgjidhjen e kredive të këqija, sepse, për mendimin tim, edhe ju jeni pjesë e kësaj loje të pistë të rëndimit të kredive të këqija, sepse edhe ju i bëni selektive, aty ku nuk arrini dot të merrni fitimin e menjëhershëm të duhur, edhe ju bëni zvarritje procesesh e të tjera. Duke shmangur konfliktin e interesit që ju mund të keni si përfaqësues të Shërbimit Përmbartimor Privat, si mundet të kontribuoni për zgjidhjen, me qëllim që të mos shkojmë në ankandin e tretë me këto nivele qesharake të vlerës 30% të kolateralit?

**Fatmir Xhafaj** –Dakord, zonja Hysi.

Fokusohuni tek ajo që doni të zgjidhni, në dy-tri probleme me argumente konkrete dhe jo në një mori problemesh. Mos u shpërndani, sepse edhe në pjesën e parë u shpërndamë shumë në detaje dhe u ç'fokusuam nga ato që duhet të trajtojmë. Prandaj, ju lutem fokusohuni shkurt që të mos jua ndërpres fjalën.

Ne gjykojmë që do të ishte me interes të keni përfaqësues.

**Tedi Malavec** – Faleminderit për pyetjet, profesoreshë, por ashtu si në shkollë, jemi në vështirësi për t'iu përgjigjur të gjithave. Po filloj nga ajo që prek drejtpërsëdrejti Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat, ndryshimin e tarifës së suksesit. Doja të thoja që në fillim se “lufta” jonë si grup interesi nuk bëhet për të ruajtur një pozicion komod të përfitimit tregtar përmbartimor në ushtrimin e veprimtarisë tonë. Ne jemi këtu dhe kemi më shumë se një vit që luftojmë shkresërisht në lidhje me kundërshtimin e këtij propozimi, sepse plani i masave ka filluar që në korrik të vitit 2015, për të mbrojtur mbijetesën dhe ekzistencën e këtij shërbimi dhe jo konformitetin dhe vazhdimësinë, ashtu siç mund të jetë grupi i interesit që foli para nesh. Për këtë arsye, i gjithë kundërshtimi ynë, oponenca jonë mbështetet në analizën që u kemi bërë të gjitha legjislacioneve dhe shërbimeve përmbartimore në Europë dhe më tej se Europa. Ne tashmë jemi anëtarë të Organizatës Botërore të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, është një organizatë që përfshin 120 shtete, ku shumica e shteteve janë në Europë, si për shembull: Franca, Holanda, Gjermania e të tjerë, të cilat e kanë të rregulluar shumë qartë mënyrën e pagesës së shpërblimit të përmbartuesit gjyqësor. Ndoshta do të duhet ta thjeshtojmë pak më tepër historinë e tarifave, ku flitet për shpërblimin e punës së një përmbartuesi për shkak të funksionit të tij. Të gjitha shtetet që përmenda, por edhe 99% e shteteve anëtare të kësaj organizate e kanë të përcaktuar dhe fikse tarifën e shërbimit përmbartimor, dhe ne kësaj i kemi referuar, ku kemi bërë edhe një propozim konkret që e pranojmë si nocion, por jo të zëvendësojmë nocionin aktual, ne e pranojmë si nocion incentiv, ashtu siç përdoret edhe në relacionin e Bankës Botërore, apo rëndomtë në relacionin e

Shoqatës së Bankave. Pra, duhen incentiva për ta detyruar përmbaruesin të lëvizë më shpejt. Po ku më shpejt, brenda procedurave fikse, apo duke i tejkaluar këto procedura? Pra, ne jemi në pozicionin e respektimit të procedurave fikse në Kodin e Procedurës Civile, të cilat kërkojnë edhe një tarifë fikse. Për më tej, me marrëveshje palësh, shumë mirë subjekti përmbarimor privat dhe çdo kreditor, aq më tepër kreditori bankar, mund të vendosë incentiva pagese në formën e shpërblimeve, të cilat duhet të përcaktohen qartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, ne kemi një propozim konkret.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, në lidhje me tarifën e suksesit, propozoj këtë gjë. Për ankandin e tretë dëgjova parafolësin, përfaqësuesin e Shoqatës së Bankave që mori dy shembuj, por faktikisht të gjitha shtetet me demokraci të zhvilluar e kanë zgjidhur më së miri procedurën e zhvillimit të një ankandi publik në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme. Zgjidhja definitive e këtij problemi në këndvështrimin tonë, por besoj të të gjithëve, është transparenca e zhvillimit të ankandeve publike. Këtu ka një problem transparence dhe unë megjithëse mbroj interesat e të gjithë Shërbimit Përmbarimor dhe të anëtarëve të tij, më duhet të pranoj me kokën ulur që ka një problem që kërkon një zgjidhje imediate, problemin e transparencës, i cili nuk mund të zgjidhet as me tre ankande, as me propozim të një vlere që mund të jetë edhe 1 paund siç e ka Anglia, por thjesht me një ankand publik dhe transparent. Pra, ne në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë po marrim një iniciativë edhe nën mbikëqyrjen e ekspertëve të huaj francezë, për të formuluar një iniciativë ligjore, e cila do të duhet ta zgjidhë përfundimisht këtë problem se si duhet të zhvillohet.

Ka një problem për propozimin e një qendre të vetme të zhvillimit të ankandeve publike, e cila do të jetë transparente dhe aty besojmë ashtu si në vendet e zhvilluara demokratike do të marrë fund ky skepticizëm që fillon dhe fshihet pas propozimeve, pas numrit të ankandeve apo përqindjeve të vlerave të kolateralëve. Nëse një ankand do të jetë thjesht publik dhe transparent në çdo moment të zhvillimit të tij, atëherë këtu nuk shihet dhe ne nuk kemi pse të shohim problem.

Për sa i takon pyetjes se si do mund të angazhohemi ne dhe të ndihmojmë procesin e përmirësimit të këtij niveli të kredive të këqija në Shqipëri, pa dashur t'ju humb kohë, them se kemi qenë shumë aktiv shkresërisht kuptohet, e përmenda edhe shkarazi po e them dhe po e përsëris që pikërisht ne grupi, i cili presupozohet të implementojë një paketë procedurale ligjore nuk jemi thirrur në asnjë rast për të dhënë mendimin tonë përveçse sot. Megjithatë, mendojmë dhe

sugjerojmë se nuk kemi pse të shkojmë shumë larg në vendet e zhvilluara perëndimore për të gjetur shkaqet e problemit apo rregullimin e tij, kemi venet fqinje si Maqedonia, Malin e Zi, të cilat kanë eksperiencën të suksesshme në uljen e nivelit të kredive të këqija, kemi modelin Podgorica në Malin e Zi, të cilët sot janë në nivelin 11%, 9% është Maqedonia, që e kanë pasur problemin tonë dhe nuk e kanë zgjidhur me draftime pas draftimesh dhe ndryshime të procedurave ligjore.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Halimi.

**Eduard Halimi** – Unë i kam lexuar shqetësimet që i keni përcjellë ju të Zyrës të Përmbartimit Shtetëror, në fakt, më fal privat, se jam një nga njerëzit që kam nxitur krijimin e përmbartimit privat, edhe modelin që kemi marrë atëherë nga Austria me ekspertë gjermanë duke u mbështetur te modeli i landit të Bavarisë, edhe për dizimin që patëm atëherë te përmbartimi shtetëror dhe privat. Në lidhje me pjesën teknike jam dakord që ta shohim me ekspertët, pasi ju keni hyrë dhe keni analizuar edhe çështjet e teknikës legislative apo çështje të oponencës së saj dhe jam dakord dhe këto çështje do t'i shohim edhe me ekspertët, por unë nuk jam dakord me disa nga gjëra që ju thoni.

E para, ju ekzistencën e varni vetëm te bankat dhe kjo nuk ka kuptim, sepse përmbartimi privat është krijuar që të mos keni vetëm bankat klientë. Ju keni 140 mijë tituj që dalin në vit kështu që ju keni edhe klientë të tjerë jo vetëm bankat, prandaj edhe në qoftë se raporti juaj me bankat prishet, kjo nuk do të thotë se ju do të lini punën dhe do të shkrihet përmbartimi privat. Pra, ky konkluzion nuk më duket se është i saktë edhe për faktin se bankat fare mirë mund të thonë që nuk punojnë fare me përmbartimin privat dhe të gjitha do t'i bëjnë te përmbartimi shtetëror, pra bëjnë një zgjidhje të tyre. Por e vërteta është që në një pjesë të kësaj që kanë propozuar bankat, në fakt shoqata e bankave ka të drejtë. Unë e kam fjalën për pjesën e sukses *fee-së*, të ndarjes. Pse ka të drejtë banka? Kjo duhet riparë në mënyrë që të jetë në standardet e duhura dhe që të zgjidhet problemi qoftë te përmbartimi shtetëror, qoftë te përmbartimi privat, sepse e kam për të dyja, pasi nuk e ndajmë qoftë për njërin, qoftë për tjetrin.

Realiteti është pak i hidhur. Që me krijimin e përmbartimit privat vetë bankat në mënyrë selektive i koncentruan dhe u dhanë përmbartuesve apo dhomave të veçanta vlera të jashtëzakonshme. Të them që e kanë bërë me proces korruptiv, kësaj nuk dua t'i hyj, sepse shoqata e bankave e di këtë punë. Degët e bankave e kanë bërë këtë duke i dhënë kaq dosje njërit, kaq dosje tjetrit, duke dhënë miliona euro dhe kanë dështuar në proces. Pra, Shoqata e Bankave me të

drejtë thotë që ne me krijimin e përmbartimit privat dosjet ua kaluam atyre dhe i kanë dhënë iks milionë euro për të ekzekutuar dhe me të drejtë bankat duan të marrin edhe *feedback*-un mbrapa. Dakord, ju dhamë kaq para, por duam të marrim edhe kolateralin dhe procesi ka dështuar. Pra, në qoftë se ka dhënë, po përmend një shifër 10 milionë euro, produkti që kanë marrë ka qenë 1 dhe banka me të drejtë thotë që kjo gjë duhet rregulluar. Siç e thashë, procesi lind edhe nga pjesa e problemeve që kanë pasur vetë drejtuesit e bankave, të cilët janë drejtuar te një apo dy zyra përmbartimore dhe aty e kanë bërë gjithë procesin dhe ato 4-5 zyra janë sofokuar me njëra-tjetrën, nuk kanë arritur ta zgjidhin dhe pastaj e gjithë pjesa e korrupsionit që përmbledh gjithë korrupsionin në sistemin e drejtësisë, ku përfshihet edhe përmbartimi.

Përmbartimi privat u krijua shumë mirë një nismë në të cilin janë edhe ata që e kanë mbështetur nismën për t'u ngritur, por ama duhet reformuar në mënyrë që të zgjidhin këto probleme.

Unë kam këtë pyetje për ju, në qoftë se problemi i sukses *fee*-së zgjidhet në këtë formë, pra që ju mos t'i merrni lekët që në fillim, sepse edhe kjo nuk shkon me thënë të vërtetën, pra pa bërë punë të merrni të gjithë vlerën nuk shkon, pasi ka dështuar, ju i keni marrë dhe bankat nuk ka marrë asnjë gjë.

Mund të më kundërshtoni duke më thënë që nuk është e vërtetë se unë e kam dëgjuar këtë ndaj ky problem duhet zgjidhur duke saktësuar pjesën e afateve. Kur do të quhet e suksesshme një procedurë ekzekutimi, sepse ashtu siç e kanë bërë bankat dhe ashtu siç ka ardhur këtu ku edhe me këstin e tretë përsëri debitori do të jetë i varur dhe ju nuk e ulni dot 21%.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dakord, edhe vitin tjetër po them, në qoftë se do të jetë 17, ju do t'i ekzekutoni duke marrë pjesë të kredisë nga shitja e kolateralit, por përsëri ai do të mbetet kreditor i keq se nuk e ka paguar pjesën tjetër.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Mund të mos jetë, por ama marrëdhënien, linkun që keni ju dhe përmbartuesi e keni të pambyllur. Pra, në qoftë se ju e lini në infinit këtë gjë, sepse ai një shtëpi kishte marrë me kredi dhe atë shtëpi ju ia morët, lekë të tjera nuk ka për të gjetur më kurrë. Kështu që përmbartuesi çfarë do të kërkojë? Në qoftë se ju i thoni përmbartuesit që do të japim 2 lekë sot dhe 8 lekë në fund në qoftë se është 10 dhe ky fundi nuk vjen kurrë, atëherë ata kanë të drejtë dhe nuk mundet dot t'i thuash 2 lekë tani dhe 8 lekë kurrë se i bie kurrë. Kjo vlerë për 2 lekë nuk bëhet dot, sepse me të



drejtë dëmtohet shërbimi duke ulur pjesën e pagimit të mirë që i bëhet shërbimit. Atëherë shërbimi do të cedojë, prandaj ky raport duhet të zgjidhet. Pra, raporti i sukses *fee*-së, i asaj që paguhet në fillim, i asaj që paguhet në mes dhe asaj që do të paguhet në një procedurë të suksesshme, në qoftë se ju thoni se ankandi i 3-të është procedura e suksesshme dhe ne e mbyllim me atë që morëm çfarë morëm dhe ju merrni lekët, mund ta kënaqë pjesën e përmbaruesve shtetërorë apo privatë, por në qoftë ju u thoni: shiko se do t'i merrni në fund fare ato lekë, gjë që nuk mund të ndodhë kurrë, apo do t'i merrni dhe nga pala tjetër në gjyq, ndërkohë që pala tjetër po të kishte lekë kishte paguar kredinë e jo më të paguajë përmbaruesit, këto janë zgjidhje pastaj që nuk janë ndonjë model, por e komplikojnë situatën, në vend që ta zgjidhni problemin që keni.

Po kthehem përsëri te shqetësimi që ju keni dhe te mbështetja që ne si politikanë u japim bankave, por jo vetëm për komponentin e stabilitetit financiar, pavarësisht në opozitë apo në pushtet. Edhe kur ata kanë qenë në opozitë e kanë dhënë me të vërtetë mbështetjen në vitin 2013 dhe ne ia japim mbështetjen qeverisë, sepse ka të bëjë me stabilitetin ekonomik të vendit nuk ka të bëjë me debatet politike dhe ne jemi për këtë gjë, por unë mendoj se duke e lënë kështu ju e komplikoni problemin. Këtë pyetje kisha për të dyja palët në këtë proces.

Në lidhje me gjërat e tjera, që thotë edhe Vasilika, për teknikën legjislative, do t'i shohim, por për punën e sukses *fee*-së, në qoftë se ju i saktësoni, a jeni të kënaqur të dyja palët dhe a keni ndonjë model ku mund të mbështetemi? Pra, të caktohet fillimi dhe fundi dhe t'i përcaktojmë në ligj dhe jo tek udhëzimi i ministrisë, sepse kam merak se mund të jetë një ministër që mund të ketë një axhendë tjetër, mund të jetë një ministër që mund të fokusohet diku tjetër dhe kështu mund të cedojë pastaj pjesa e shërbimit. Ta përcaktojmë në ligj sa duhet të jetë sukses *fee*-ja, sa duhet të jetë në fillim, sa duhet të jetë në mes, sa duhet në fund dhe kur është fundi dhe kur është fillimi. Pjesën tjetër duhet ta rregulloni ju të Shoqatës së Bankave, pjesën e korrupsionit që keni me degët në shpërndarjen e dosjeve dhe ju këtë e keni problem, ju e dini. Është një çështje që nuk e zgjidhim ne këtu me ligj, është një çështje e brendshme e juaja, por ashtu siç keni problem me vlerësuesit, të cilët edhe ata bëjnë korrupsionin në fillim dhe pastaj asnjëri prej tyre... E kam pyetur kryetarin e Shoqatës së Bankave: a keni bërë gjatë këtyre 2 vjetve një kërkesë të vetme për heqjen e një licence? Më ka thënë jo. E kam pyetur nëse keni bërë një kërkesë për heqjen e licencës të një përmbaruesi privat? Më ka thënë jo. Pra, i gjithë i sistemi bankar, edhe ministri përgjegjës e ka këtë problem, pasi unë jam në opozitë dhe mund t'i thosha se e ka fajin iks ministër i Financave apo i Drejtësisë, por këtë nuk mund ta them dot kur ai nuk ka pasur kërkesë nga banka.

Pra, ju keni bërë edhe për gjyqtarët zero kërkesa në dy vjet. A ka gjyqtarë të korrumpuar, të cilët kanë shkelur procedurat e këtij ligji? Patjetër që ka. E kam pyetur: “Sa kërkesa keni bërë ju te ministri apo te Këshilli i Lartë i Drejtësisë?” dhe ai më është përgjigjur se nuk kanë bërë asnjë. Sa kërkesa keni bërë ju për vlerësuesit, të cilët licencohen nga qeveria? Më ka thënë asnjë. Sa kërkesa keni bërë për t’u hequr licencat përmbauesve privatë, të cilët edhe mund të kenë bërë nga këto allishverishe siç thonë, më ka thënë asnjë. Këtu është edhe pjesa juaj e përgjegjësisë.

A mund të ketë një konsensus për këtë sipas ndonjë modeli, që të përcaktohet me sukses? Se edhe kështu që t’i marrësh që në fillim dhe të mos bësh asnjë punë nuk shkon, ka dështuar. Po të kishte pasur sukses, do të thosha shumë mirë, por ka dështuar.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

A ka ndonjë përgjigje? Po.

**Tedi Malaveci** – Standardi ndërkombëtar i tarifimit të shërbimit përmbauesve përfshin edhe parapagimin. Këtu ka një keqkuptim të madh në interpretimin e parapagimit, një keqkuptim që zgjat tashmë ndër vite ku supozohet që përmbauesi merr një punë dhe nuk jep një produkt dhe zgjidhja kërkohet te copëtimi i tarifës së shpërblimit, e theksoj gjithmonë që të kuptohet mirë. Faktikisht, tarifa fikse në standardet ndërkombëtare ashtu si dhe tek i yni parashikon një kontestim që duhet të mbulojë një risk që përmbauesi gjyqësor e kryen në aktivitetin dhe punën e vet. Ky risk është edhe financiar, por ka edhe risk të natyrës tjetër që ju e dini mirë dhe për këtë arsye janë vendosur tarifat fikse, sepse nuk mund të mbart riskun e kreditorit vetë një operator përmbauesve privat. Kjo është arsyeja që çdo kreditor, qoftë kreditori bankar, por edhe të tjerët, sepse ne jemi të shqetësuar në sensin e ndryshimit të projektligjeve edhe për të gjithë kreditorët, siç e thatë edhe ju se janë me mijëra, do të duhej të kontraktohej një shërbim dhe një subjekt përmbauesve. Pra, ka një kontratë tip dhe ju e dini mirë se keni qenë miratuesi i parë i kontratës i kontratës “tip” të shërbimit. Kjo kontratë mbart të drejtat dhe detyrimet të përcaktuara, të cilat janë të referuara në ligj për kryerjen e veprimeve të përcaktuara dhe detyrime. Nëse nuk i respekton këto të drejta, kreditori ka të drejtë të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë dëmshpërblim për kohën e humbur dhe për çdo problem që mund t’i ketë shkaktuar shërbimi i munguar i atij përmbauesve të kontraktuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Patjetër. Jemi përpara një kontrate. Përpara një viti e gjysmë, në një takim që organizojnë të tretët dhe nuk e kemi pasur drejtpërdrejt me shoqatën, kam deklaruar, si ka mundësi 10 mijë kontrata shërbimi në pothuaj 5 vjet nuk kanë asnjë kërkesë për zgjidhje të njëanshme të tyre? Pra,

supozohet që shërbimi përbarimor ka funksionuar 100% dhe pozitivisht. Është ajo që thatë edhe ju, dhe është fakt që kontrata e shërbimit është një kontratë dypalëshe. Ne sigurojmë edhe aktivitetin profesional në kompani sigurimesh dhe mbajmë përgjegjësi profesionale në kuptimin e zhdëmtimit financiar që ju mund ta kërkon drejtpërdrejt, por edhe në gjykatë. Asnjë rast i tillë, pasi është një fakt tjetër që më pak se 5% e shërbimit përbarimor në 5 vjet është kontraktuar për ekzekutimin e detyrimeve që i kalojnë 1 miliard euro. Ky është fakt dhe anatemohehet i gjithë shërbimi përbarimor privat.

Zoti deputet, ish-ministri i Drejtësisë e preku disi këtë fakt. Ne kemi kërkuar një analizë ku kërkohen zgjidhje, draftime pa bërë një analizë të problemit. Cila është analiza? Një statistikë. Ku është problemi dhe pse nuk janë ekzekutuar detyrimet?

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Fatmir Xhafaj-** Kishit koment tjetër?

**Tedi Malaveci-** E pranojmë logjikën e tarifës së shpërblimit me sukses nga një punë relativisht e shpejtë, por gjithmonë pas përcaktimit të tarifave fikse. Kush do ta mbulojë riskun e shërbimit apo të subjektit përbarimor në territorin social shqiptar? Riskun e bankave po e kërkojmë vit pas viti duke ndryshuar legjislacionin procedural.

**Fatmir Xhafaj-** Faleminderit! Prezantohuni ju lutem.

**Lorval Petanaj** – Lidhur me problemin e *sukses fee-s*, disa kohë më parë është bërë një udhëzim nga ministri i Drejtësisë, udhëzimi nr. 1665/1, datë 05.03.2014 dhe në miratimin e këtij udhëzimi, është fakt evident që doli edhe në media, u votua nga shoqata e bankave dhe në rrjetin e shoqatave të bankave, një pjesë dërmuese e tyre ishin kundër ndryshimit të *sukses fee-s*, sepse ishin të kënaqura nga shërbimi përbarimor. 7 banka kanë votuar kundër ndryshimit dhe 6 prej tyre....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

9 me 5, pra disa grupe bankash kanë qenë të kënaqura nga shërbimi përbarimor dhe nuk kanë dashur të bëjnë ndryshime.

Ku ndryshon nocioni i konceptit të përbarimit privat nga ai shtetëror? Të dyja shërbimet operojnë me të njëjtët nene dhe Kodin e Procedurës Civile, pra bazën ligjore të funksionimit të punës së tyre e kanë njëloj. I vetmi ndryshim mes tyre është mënyra e pagesave. Nëse i gjithë problemi i përbarimit privat dhe përbarimit shtetëror qëndron tek ulja e vlerave të kredive të

këqija, atëherë bankat e kanë gjetur zgjidhjen, nëse janë të pakënaqura nga shërbimi privat, mund të kërkojnë ndihmën e shërbimit shtetëror.

Në bazë të informacionit që kemi, bankat nuk kanë kërkuar që të ulen shpenzimet e tarifave të përmbaruesve duke kërkuar shërbimet e përmbarimit privat apo shtetëror. Ndoshta edhe mua do të më pëlqente që skuadra ime e futbollit të luante me Kristiano Ronaldon, por nuk kam mundësi ta paguaj. Ne pretendojmë që këtë shërbim të mirë ia kemi ofruar dhe në rast se ka pasur pakënaqësi, siç e tha edhe kryetari i dhomës, mund të kërkojnë zgjidhjen e kontratës me përmbaruesin. Është treg i lirë, treg zgjedhjeje.

**Fatmir Xhafaj** - Që janë bashkë në gjithë këtë histori, vetëm të jesh i mangët të mos e kuptosh. Problemi është që edhe siç thoni ju, ta merrni të gjithën që në fillim dhe më pas të ikni dhe pas jush të vijë dikush tjetër dhe të rifillojë nga e para duke i dhënë pjesën tjetër, kjo nuk shkon.

**Lorval Petanaj** - Më falni, zoti kryetar. Duhet të gjendet përgjegjësia.

**Fatmir Xhafaj** - Ne nuk jemi këtu për përgjegjësinë. Pavarësisht asaj që tha zoti Halimi dhe asaj që thashë unë tani, ne e thamë përgjegjësinë. Është e dyanshme. Ju keni pjesën tuaj, ata kanë pjesën e luanit në këtë histori, sepse ata e kanë bërë dhe drejtuar gjithë këtë operacion dhe situatën ata e kanë krijuar. Ky është koncepti që kam unë për këtë gjë, por ne duam të gjejmë mënyrën si ta zgjidhim këtë, dhe mënyra si është sot, nuk është shumë e mirë. Si mund të zgjidhet që të dyja palët të jenë në rol aktiv në këtë proces.

**Lorval Petanaj** - Ka edhe një mënyrë tjetër. Shërbimit përmbarimor privat t'i atashohet edhe shërbimi i kolektorit. Ky është një operacion *collection*. Sa para mbledh, aq paguan. Nuk mundet që të jesh përmbarues, të ecësh në bazë të neneve të Kodit të Procedurës Civile dhe unë kam detyrimin ligjor. Kur lidh një kontratë me bankën....

**Fatmir Xhafaj** - Kemi ndonjë ligj për *connection*? Unë di që nuk kemi.

**Lorval Petanaj** - Ky është shërbim *collection*.

**Fatmir Xhafaj** - Pavarësisht se ata e japin, e bëjnë sot.

**Lorval Petanaj** - Po pra, e bëjnë këtë.

**Fatmir Xhafaj** - E bëjnë me marifete të tjera bankat, por që ne nuk e kemi në ligj.

**Lorval Petanaj** - Unë kur lidh një kontratë me bankën, them: unë të ofroj shërbimin e përmbaruesit. Cili është shërbimi i përmbaruesit? Unë nuk të them ty që të garantoj 100% kthimin

e lekut. Unë do të zbatoj Kodin e Procedurës Civile. Ai nuk thotë që në përfundim nuk kam nga të shkoj, kthehem në një bankë dhe të filloj të ushtroj presion t'u paguaj lekët qytetarëve.

**Fatmir Xhafaj** - Zoti Halimi, ju lutem.

**Eduard Halimi** – Kur krijon përmbarim privat, që të mos kishim nga këto sa mund të parashikohen, se nuk mund t'i parashikosh dot të gjitha, por meqenëse isha i pasionuar mbas kësaj fushe dhe e kam me ju të bankave, hartuam regjistrin elektronik të përmbarueseve, në mënyrë që çdo gjë të ishte elektronike, ministri do të kishte akses të plotë për të kontrolluar gjithë procesin ku ishte dosja e përmbaruesve privatë, si edhe shtetërorë. Përveç kësaj, kemi bërë një marrëveshje me Sejhanin, ish-kryetarin e bankave. Cila ishte marrëveshja? Do të fillonin historitë me bankat, do të duhej të zgjidhnim problemin e bankave çfarë interesi kishim ne. Dhe menduam sistemin e regjistrimit elektronik të përmbaruesve dhe ju do të ndërtonit sistemin tuaj, atëherë bëmë marrëveshje me bankat dhe për çdo procedurë që do të kishit me përmbaruesit, do të kishit sistemin e vigjilencës me një llambë që do të ndizej, gjithë investimi që do të bënte banka kapte shumën prej 45 mijë dollarë, kaq ishte. Kanë qenë tre persona, Sejhani, drejtori i bankës Raifaissen, Kristiani ka qenë dhe drejtori i bankës Alfa. Kemi rënë dakord dhe çfarë do të bënim? Si do të shpërndareshin nga bankat? Do ta kishit me një sistem transparent që do ta kontrollonit ju, jo qytetarët, shoqata e bankave do të kontrollonte si u shpërndanë dosjet e kredive, dhe në momentin kur Tedi Malaveci nuk do ta kishte ekzekutuar, automatikisht juve ju ndizej llamba e kuqe që ka kaluar afati dhe do të shihnit që, nëse këta 100-200 përmbarues nuk do të kishin performancë të mirë, atëherë ju do të thoshit: ky nuk na pëlqen më, do të marrim këtë tjetrën që mund të ecë më mirë dhe të ketë performancë më të mirë. Por ju nuk e bëtë kurrë. Nëse doni diçka për ta zgjidhur, të mos lidhet me faktin e ka bërë ky ministër apo një ministër tjetër, thjesht bëjeni këtë gjë në mënyrë që të zgjidhni problemin e përmbaruesve me një sistem që kushtonte 45 mijë dollarë. Një sistem që do të ndërtohej edhe me stemën e alarmit dhe vigjilencës, dhe më pas shikonit kush performon ose jo. E zgjidhni kontratën me këtë, e çojmë për ndjekje me atë etj., me sistemin si lidhet me *one stop shop*, pastaj me noterët për pjesën e hipotekës, por që edhe atë nuk e keni bërë. Ajo ishte një vlerë e tillë që, nëse një noter do të bënte një kontratë që këtë pronë që ju e kishit kolateral, ia jepte/hiqte dikujt tjetër, menjëherë ndizej llamba e emergjencës gjithmonë në funksion të vigjilencës që duhet të keni ju për pjesën e kredive të këqija.

Kurse për pjesën tjetër, duhet të gjendet një konsensus që nuk duhet të jetë e gjitha, por duhet të jetë me këste. Më pas këstet t'i marrim, t'i përcaktojmë sipas procedurave. Dakord jeni dhe ju besoj.

**Fatmir Xhafaj** - Kjo puna e regjistrimit më duket interesante dhe mund ta përfshijmë, t'i detyrojmë ata në mënyrë që të ketë më shumë transparencë. Edhe çështja e qendrës së ankandeve m'u duk interesante për ministrinë. Ndoshta do të na i thotë ministria. M'u kujtua sepse, po të lexosh gazetën, duhet të shkosh diku në faqen 17, shikon shoqëria përmbartimore me germa të vogla, është mjeshtëri më vete dhe them: te këto rreshta do të ngelet e gjithë kjo histori? Është qesharake. Mirë këta, po banka? Kë bën banka?

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Pse ti mendon që unë shikoj faqet e *website* të bankës? Po unë mezi lexoj gazetën. Megjithatë, t'i dëgjojmë një herë këta të shoqatës dhe ju ta përmbyllni.

Faleminderit!

**Spiro Brumbulli**- Vetëm një fjali kam, sepse nuk na takon të hyjmë shumë në detaje.

**Fatmir Xhafaj** - Ju takon sepse ata propozojnë tjetër gjë.

**Spiro Brumbulli** -Ne i qëndrojmë atij varianti. Nuk është varianti ynë. Jemi ulur në tavolinë, ka qenë edhe Banka Botërore, e cila ka sjellë eksperiencat dhe standardet më të mira sidomos për vendet në zhvillim, nga ana tjetër, ne nuk i kemi drejtuar Anglisë dhe Gjermanisë, por është Çekia, Hungaria, Bullgaria, Maqedonia, konfirmimin e pret edhe Polonia, të cilat janë në këtë model që kemi propozuar ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Ka qenë varianti që nënshkruhej një udhëzim i përbashkët për tarifatat dhe mënyrën sesi ndaheshin. Jam dakord që të marr edhe propozimin që bëtë ju dhe këtë e kisha pikën e dytë që mund të përcaktohet edhe në ligj. T'juaj sjellim deri ditën e premte propozimin për këtë sesi mund të jetë me faza.

Faleminderit!

**Bledar Dervishaj** - Sërish një koment të shkurtër, të nderuar, me kolegun Malaveci kemi pasur shumë diskutime edhe gjatë tryezave të përbashkëta ku ka qenë edhe sektori bankar. Kemi arritur në një propozim të tillë që struktura e tarifimit të ndahej në këtë lloj mënyre dhe do të mirëprisnim një ripropozim ndoshta edhe nga sektori bankar, edhe nga Dhoma Kombëtare sesi mund ta riformuloni suksesin, ç'do të thotë sukses dhe si vilet ai. Le të diskutohet në Komisionin

e Ligjeve dhe Ministria e Drejtësisë do të japë një opinion më të saktë. Për më shumë do t'i qëndroja edhe pyetjes së kryetarit të komisionit për Qendrën e Integruar të Ankandeve Publike. Unë, Tedi si edhe zoti Pilo, drejtori i Përmbarrimit Shtetëror, që është në sallë, jemi të tre aktorë kryesorë në një projekt binjakëzimi të përmirësimit përmbarrimor në Shqipëri, ku është një konsorcium francez dhe holandezi cili ka marrë përsipër të na ofrojë asistencë teknike. Një nga aktivitetet e ndryshuar së fundi dhe të rena dakord me komitetin drejtues të këtij projekti binjakëzimi, është ideja e ministrit të Drejtësisë për dhënien e asistencës ligjore, teknike, por, pse jo, edhe draftimin e një draftligji për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Integruar të Ankandeve. Një ide fillestare ishte që mund të organizohej me qendër në Tiranë dhe me dy degë fillestare një në Veri dhe një në Jug. Në vijim, zbatimi i kësaj qendre, do të vijë me atë metodologji unike të vlerësimit për të mos pasur disa metodologji, siç ndodh sot rëndom.

Gjatë muajit shtator kemi një vizite nga një ekip francez, i përbërë prej 5 ekspertësh prokurorë, ish- gjyqtarë e të tjerë, i cili do të kryejë një vizitë në Tiranë, në kuadrin e këtij projekti. Mendohet që në datën 20 tetor të dorëzojnë produktin, një studim dhe projekt-draft si mund të funksionojë në Shqipëri një qendër e integruar ankandesh dhe, bashkë me të, ndryshimet që mund të kërkojnë Kodi i Procedurës Civile, ligji për përmbarrimin ose dhe ligjet e tjera të lidhura me të.

Pra, ideja fillestare ishte, sa e njohin kuadrin tonë ligjor, ia kërkuam edhe ekspertit francez. Ata kanë një vit që merren këtu me këtë projekt, për Qendrën e Integruar e Ankandit Publik, ku jo vetëm përmbarruesit, por edhe pasuritë e tjera të sekuestruara në format e zhvillimit të gjyqit penal të bëhen pjesë e këtij ankandi publik transparent, me sa më shumë transparencë, publikim online apo ebay. Në Francë për shembull, kur ne ishim për vizitë bashkë me zotin Malaveci, funksiononte që ankandin e bënte gjyqtari dhe nuk merrte pjesë pala, por vetëm përfaqësuesi i tij me prokurë avokati. Pra, kishin një sistem të ndryshëm, ndërsa sendet e luajtshme mund të kryheshin në një qendër tjetër, e cila mund të kryhej edhe nga noteri. Pra, kishin disa lloj variantesh ashtu siç mund të flasim edhe për nivele të ndryshme tarifimi ose forma të ndryshme përmbarrimi. Në Francë kishte diçka tjetër dhe shtetet e tjera kanë forma të tjera. Ne menduam se kjo është më e drejta për t'i dhënë zgjidhje problematikës së edhe atij bashkëpunimi midis punonjësve në sektorin bankar dhe disa përmbarruesve, jo me të gjithë.

A është kjo më e drejta? Pranojmë sugjerime. Hajdeni të ndërtojmë një strukturë më të qartë, më të pastër, më objektive për të gjithë, por kryesisht në mënyrë që ta vinim përmbarruesin

në pozita pune, pra atë që vjel ta gëzonte me punë, jo atë që vjel ta rehatojë për të mos bërë veprime të tjera shtesë, ose të jetë më agresiv në punë. Ky ishte qëllimi i tarifës së suksesit.

**Albert Pilo** – Unë jam Albert Pilo drejtor i Përgjithshëm i Përmbarrimit Shtetëror. Ju dëgjova me vëmendje edhe në takimin e parë, edhe në takimin e dytë.

Nuk dua të zgjatem, por kam mendimin, të cilin e kam shprehur edhe në Ministrinë e Drejtësisë, se në radhë të parë duhet të ketë një strategji pak më të qartë se çfarë lloj përmbarrimi duhet të ketë në vendin tonë. Ne ende nuk kemi një strategji të saktë, nëse do të kemi një përmbarrim privat, përmbarrim shtetëror apo një përmbarrim miks. Mbi këtë bazë, një nga parimet do të jetë edhe vendosja në balancë të barabartë të shërbimeve. Unë dëgjova me vëmendje zotin Halimi për iniciativën që ka marrë në atë kohë për formimin e shërbimit përmbarrimor privat dhe, sigurisht, të gjithë dëshirojmë që të bëhen gjëra të mira. Por jo gjithmonë gjërat dalin të suksesshme, siç është rasti i situatës që diskutojmë sot, pasi me të vërtetë u krijua shërbimi përmbarrimor privat, por, po të marrësh të gjithë dokumentacionin e saj kohe dhe ta lexosh, në mes të tjerash thuhet: “ky shërbim do të krijohet për t’i ardhur në ndihmë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore e të tjera”. Pra, nuk thuhet shërbim përmbarrimor privat për bankat. Ndërsa në të vërtetë nuk ka ndodhur kështu. Ka ndodhur krijimi i shërbimit përmbarrimor privat, i cili sot ka 200 përmbarrues, të cilët merren vetëm me bankat dhe kanë sjellë këtë situatë ku jemi dhe një shërbim përmbarrimor shtetëror të shkatërruar. Në ç’kuptim të shkatërruar? Të shkatërruar në numër, në infrastrukturë dhe gjithçka tjetër. Atëherë në ç’lloj pozitash jemi ne me njëri- tjetrin? Ku do të shkojnë bankat te përmbarrimi shtetëror? Nëse Shërbimi Përmbarrimor Shtetëror, i cili për mua është shumë rentabël sot, derdh shumë të ardhura në arkën e shtetit, ka një ekip të përgjegjshëm, pse nuk forcohet? Përse ky shërbim nuk rritet në numër? Përse këtij shërbim nuk i jepet infrastrukturë? Ky shërbim derdh miliardë lekë në arkën e shtetit dhe nuk merr asnjë lekë nga arka e shtetit për të investuar. Nëse këto dy shërbime do të ishin në pozita të barabarta, atëherë edhe banka dinte kë zgjidhte.

Ne kemi një projekt binjakëzimi për të cilin foli zoti Malaveci. Është e vërtetë që Franca ka shërbim përmbarrimor privat, por në Francë ka edhe diçka tjetër, edhe pse janë privatë, ka një tavan të tarifës, e cila nuk shkon më shumë se 2500 euro, dhe, kur nuk e ekzekuton vendimin, eurot kthehen mbrapsht. Në Shqipëri nuk është.

Nuk është e vërtetë që shumica janë privatë. Janë rreth 15 vende që e kanë privat, 15 vende shtetërore dhe 17 vende miks. Unë më shumë e kam për Ministrinë e Drejtësisë, por edhe për t’i dhënë një informacion komisionit, sepse mendoj se këtu do të jetë baza për të parë si mund



të ecet më tej, por fee-ja e suksesit për mua duhet të jetë. Mënyra si duhet të ekzekutohet është problem tjetër, por pa bërë punë të marrësh lekët, kjo gjë nuk shkon.

**Fatmir Xhafaj** – A ka ndonjë mendim tjetër?

Faleminderit!

Faleminderit përfaqësuesve të shoqatës së bankave, dhe Shërbimit Përmbarimor Privat dhe shtetëror dhe Ministrisë së Drejtësisë që është inicuesja dhe përfaqësuesja e qeverisë në shqyrtimin e këtyre projekteve.

Besoj se u kuptua se cili është qëllimi dhe këndvështrimi që kanë ligjvënësit, prandaj mbi këtë bazë të keni mundësi të reflektoni dhe brenda javës të sillni qëndrimin tuaj me shkrim për çështje që janë në interesin tuaj dhe në interes të gjykimit të këtyre projekteve.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**